

SHTOJCË 3 e

**parashtrimi të versioneve të korigjuara dhe të redaktuara publike të Aktakuzës
së konfirmuar dhe kërkesave lidhur me të**

Rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*

Vetëm për Gjykatësin e Procedurës Paraprake, Administratoren dhe Prokurorin e
Specializuar



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-06
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 4 nëntor 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*

Aktakuzë e redaktuar më tej

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar, në përputhje me kompetencën e tij në bazë të neneve 35(2)(i) dhe 38(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), akuzon:

Hashim THAÇIN

Kadri VESELIN

Rexhep SELIMIN

Jakup KRASNIQIN

Për **krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare**, të ndëshkueshme në bazë të neneve 13 dhe 16(1) të Ligjit dhe **krime lufte sipas të drejtës ndërkombëtare**, të ndëshkueshme në bazë të neneve 14 dhe 16(1) të Ligjit, sikurse shtjellohet në vijim.

TË AKUZUARIT

Hashim THAÇI

1. **Hashim THAÇI, gjithashtu i njohur si Gjarpri**, emri i babait [REDAKTUAR], u lind më 24 prill 1968 në Burojë, komuna e Skënderajt, Kosovë. Ai ka shtetësi kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).
2. **Hashim THAÇI** ishte anëtar themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('UÇK'), e njohur në anglishte si *Kosovo Liberation Army* ('KLA') dhe i Shtabit Qendror ose Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ('Shtabi i Përgjithshëm'). Ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë vitit 1998 dhe në 1999. Qershori i vitit 1998 e gjeti **Hashim THAÇIN** shef të Drejtorisë Politike dhe asaj të Informimit. Në fund të marsit 1999, **Hashim THAÇI** ishte Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ('QPK') dhe Kryekomandant i UÇK-së.
3. Në nëntor 1999, **Hashim THAÇI** ishte anëtar themelues dhe udhëheqësi i Partisë për Progres Demokratik të Kosovës ('PPDK') e cila në vitin 2000 mori emrin Partia Demokratike e Kosovës ('PDK'). Në vitin 2008, ai u zgjodh Kryeministër i

Kosovës. Në 2014, **Hashim THAÇI** u bë zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme. Në 2016, ai u zgjodh President i Kosovës.

Kadri VESELI

4. **Kadri VESELI, gjithashtu i njohur si Luli**, emri i babait [REDAKTUAR], u lind më 31 maj 1967 në Mitrovicë, komuna e Mitrovicës, Kosovë. Ai ka shtetësi kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).

5. **Kadri VESELI** ishte anëtar themelues i UÇK-së dhe i Shtabit të Përgjithshëm. Ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë vitit 1998 dhe në 1999. Në qershor 1998, **Kadri VESELI** ishte anëtar i Drejtorisë Politike dhe shef i shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Në fund të marsit 1999, pas krijimit të QPK-së, **Kadri VESELI** ishte shef i Shërbimit Informativ të Kosovës ('SHIK') dhe ministër i Shërbimit Informativ në QPK.

6. Viti 2013 e gjeti **Kadri VESELIN** në postin e zëvendëskryetarit të PDK-së. Në vitin 2014, ai u bë Kryetar i Kuvendit të Kosovës. Në vitin 2016, me zgjedhjen e **Hashim THAÇIT** si President i Kosovës, **Kadri VESELI** u bë udhëheqësi i PDK-së.

Rexhep SELIMI

7. **Rexhep SELIMI, gjithashtu i njohur si Dhjetëshi ose Agroni ose Tafili ose Lulzimi**, emri i babait [REDAKTUAR], u lind më 15 mars 1971 në Aqarevë, komuna e Skënderajt, Kosovë. Ai ka shtetësi kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).

8. **Rexhep SELIMI** ishte anëtar themelues i UÇK-së dhe i Shtabit të Përgjithshëm. Ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë vitit 1998 dhe në 1999. Në qershor 1998, **Rexhep SELIMI** ishte tashmë shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së. Më së paku në gusht 1998, ai ishte Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së. Nga fundi i marsit 1999, me krijimin e QPK-së, ai u bë ministër i Rendit Publik /ministër i Punëve të Brendshme.

9. Në nëntor 1999, **Rexhep SELIMI** ishte anëtar themelues i PPDK-së së **Hashim THAÇIT**, e cila në vitin 2000 mori emrin PDK. Në vitin 2000, **Rexhep SELIMI** ishte

oficer i lartë në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Në vitin 2010, **Rexhep SELIMI** u zgjodh në Kuvendin e Kosovës.

Jakup KRASNIQI

10. **Jakup KRASNIQI**, emri i babait [REDAKTUAR], u lind më 1 janar 1951 in Fatos (Negroc), komuna e Drenasit (Gllogocit), Kosovë. Ai ka shtetësi kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).

11. Nga fillimi i vitit 1997, **Jakup KRASNIQI** ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë vitit 1998 dhe në 1999. Qershori i vitit 1998 e gjeti **Jakup KRASNIQIN** anëtar të Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar të UÇK-së. Më vonë në 1998, **Jakup KRASNIQI** u emërua zyrtarisht zëvendëskomandant i UÇK-së. Me krijimin e QPK-së, **Jakup KRASNIQI** u bë zëdhënës i QPK-së.

12. **Jakup KRASNIQI** ishte anëtar themelues i PPDK-së së **Hashim THAÇIT**, e cila në vitin 2000 mori emrin PDK. **Jakup KRASNIQI** u bë Kryetar i Kuvendit të Kosovës në dhjetor 2007. Në periudhën prej shtatorit 2010 deri në prill 2011, **Jakup KRASNIQI** ishte ushtrues i detyrës së Presidentit të Kosovës.

PARAQITJA E FAKTEVE

Historiku

13. Në vitin 1989, në kontekstin e tensioneve dhe ndasive në rritje në të gjithë Jugosllavinë e atëhershme, Kosovës iu hoq statusi i krahinës autonome. Pas kësaj, shumica dërrmuese e shqiptarëve të Kosovës mbështetën një referendum për pavarësi, miratimin e një kushtetute dhe krijimin e institucioneve shtetërore paralele, ndër të cilat edhe një qeveri e udhëhequr nga partia më e madhe politike në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës ('LDK'), me President Ibrahim RUGOVËN dhe Kryeministër Bujar BUKOSHIN. LDK-ja ndoqi një politikë të qëndrueshme jo të

dhunshme, mohoi legjitimitetin e qeverisjes së Kosovës nga Serbia dhe krijoi sisteme paralele të arsimit, shërbimit shëndetësor dhe të tatimeve.

14. Gjatë gjithë viteve '90, grupe të diasporës të shqiptarëve të Kosovës u organizuan për t'iu përgjigjur situatës në Kosovë në mënyra të ndryshme. Gjatë së njëjtës periudhë, individë dhe grupe të vogla brenda Kosovës ndërmorën sulme të armatosura kundër autoriteteve të Republikës Federale të Jugosllavisë ('RFJ'). Lëvizja Popullore e Kosovës ('LPK'), një organizatë nacionaliste shqiptare që ekzistonte prej kohësh, mbështeste idenë se për çlirimin e Kosovës nga Serbia ishte i nevojshëm përdorimi i forcës së armatosur.

15. Në fund të vitit 1993, LPK-ja krijoi një sektor të posaçëm për bashkërendimin e veprimtarive të njësiteve të armatosura në Kosovë. Në vitin 1994, LPK-ja tashmë përdorte emrin UÇK për organizatën në kuadër të së cilës po bashkoheshin grupet e armatosura në Kosovë. U krijua një Shtab Qendror ose i Përgjithshëm (që më lart përkufizohen bashkërisht si 'Shtabi i Përgjithshëm') në të cilin bënë pjesë Azem SYLA, Xhavit HALITI, **Hashim THAÇI**, **Kadri VESELI**, **Rexhep SELIMI**, Lahi BRAHIMAJ dhe Sokol BASHOTA. Në vitin 1997 Shtabit të Përgjithshëm i ishte bashkuar edhe **Jakup KRASNIQI**. **Hashim THAÇI** dhe **Kadri VESELI** merreshin, ndër të tjera, me organizimin e UÇK-së, duke përfshirë edhe mbajtjen e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë dhe atyre që ishin të vendosur gjetkë. **Rexhep SELIMI** e kishte bazën në Kosovë dhe, bashkë me të tjerë, forcoi dhe bashkërendoi veprimet e armatosura në terren. Sikurse u përshkrua më lart, që të gjithë, **Hashim THAÇI**, **Kadri VESELI**, **Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI**, vazhduan të mbanin poste të larta në UÇK dhe/ose QPK gjatë periudhës që lidhet me këtë aktakuzë.

Elementët kontekstuale

16. Anëtarët dhe instrumentet (përkufizuar më poshtë) e NKP-së kryen një sulm gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile të kundërshtarëve

(përkufizuar më poshtë) në Kosovë dhe në zona të Shqipërisë Veriore, së paku që prej marsit 1998 deri në shtator 1999 (‘periudha e aktakuzës’).

17. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e paraqitura në këtë aktakuzë si krime kundër njerëzimit, ishin pjesë e sulmit gjerësisht të përhapur dhe sistematik drejtuar kundër kundërshtarëve. Krimet ndiqnin një praktikë të njëjtë, ndikonin në familjet e gjera dhe komunitetet e viktimave dhe synonin të shërbenin si paralajmërim dhe të ushtronin trysni mbi popullatën e vënë në shënjestër në tërësi, për të parandaluar kundërshtimet ndaj UÇK-së/QPK-së dhe për të detyruar bashkimin absolut rreth tyre. Anëtarët dhe instrumentet e NKP-së kishin dijeni për këtë sulm dhe që sjellja e tyre ishte pjesë e tij.

18. Gjithashtu, gjatë gjithë periudhës së aktakuzës, ekzistonte konflikt i armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave (‘UJ’), njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme (‘MPB’) dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë (bashkërisht, ‘forcat e RFJ-së’). Forcat e RFJ-së përfshinin forcat e rregullta ushtarake të RFJ-së dhe të Republikës së Serbisë.

19. Ndonëse fillimisht vepronte në ilegalitet, gjatë të gjithë periudhës së aktakuzës UÇK-ja ishte një grup i armatosur i organizuar, me një shkallë të mjaftueshme organizimi për të mbajtur nën kontroll territor dhe për të planifikuar dhe kryer sulme të armatosura të bashkërenduara si dhe operacione të tjera ushtarake sulmuese dhe mbrojtëse. UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm, ishte e organizuar në (nën)zona operative dhe lëshonte deklaratat politike dhe komunikata në të cilat parashtronte politikën e saj. Së paku që nga prilli 1998 dhe duke vazhduar gjatë të gjithë periudhës së aktakuzës, anëtarë të UÇK vunë në funksionim qendra – shumë nga të cilat ishin prej kohësh vatra dhe baza të forta të saj – në të cilat, ose rreth të cilave, anëtarë dhe instrumente të NKP-së mbajtën të ndaluar, keqtrajtuar dhe/ose vranë qindra kundërshtarë. Së paku që prej qershorit 1998, UÇK-ja kishte një zëdhënës zyrtar dhe rregulla e rregullore të ndryshme në formë të shkruar.

20. Në fillim të vitit 1998, konflikti i armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së u ashpërsua. Në shkurt dhe në fillim të marsit 1998, forcat e RFJ-së kryen sulme në Qirez, Likoshan dhe Prekaz. Gjatë sulmit të 5 marsit 1998 në Prekaz, Skënderaj, forcat e RFJ-së vranë mbi 50 persona, ndër të cilët edhe Adem JASHARIN, një komandant i shquar i UÇK-së, dhe shumicën e anëtarëve të familjes së tij. Vrasja e JASHARIT dhe e anëtarëve të familjes së tij u raportua gjerësisht në media duke bërë që lajmin ta mësonin anëtarët e diasporës së shqiptarëve të Kosovës në mbarë botën. Pas kësaj, mijëra individë nga diaspora dhe Kosova u paraqitën vullnetarë për t'iu bashkuar UÇK-së dhe anëtarë të LPK-së e të UÇK-së që më parë ndodheshin jashtë vendit, u kthyen në Kosovë.

21. Nga 31 marsi 1998, konflikti ishte përshkallëzuar në atë masë sa që Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ('OKB') miratoi Rezolutën 1160, e cila ndalonte shitjen ose furnizimin e RFJ-së me armatime dhe materiale përkatëse, i bënte thirrje RFJ-së të merrte masa për arritjen e një zgjidhjeje politike për gjendjen në Kosovë dhe nxiste UÇK-në që të dënonte veprimet terroriste dhe të kërkonte realizimin e synimeve të saj me mjete paqësore.

22. Në mes të këtij konflikti në zhvillim e sipër, në mes të korrikut 1998, njësitet e UÇK-së sulmuan Rahovecin dhe fshatrat përreth. Gjatë sulmit u rrëmbyen civilë serbë të cilët më vonë u mbajtën të ndaluar, u keqtrajtuan dhe u vranë. Pak kohë më pas, forcat e RFJ-së filluan një ofensivë të përmasave të mëdha në mbarë Kosovën, e cila zgjati disa javë, si dhe kryen operacione të mëtejshme në shkallë të gjerë në periudhën gusht-tetor 1998.

23. Më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1199, në të cilën shprehej shqetësim i madh për 'luftimet e ashpra të kohëve të fundit në Kosovë dhe në veçanti për përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës prej forcave serbe të sigurisë dhe Ushtrisë Jugosllave, që kanë shkaktuar viktima të shumta civile dhe, sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, zhvendosjen e më se 230 000 personave nga shtëpitë e tyre'. Më tej, Rezoluta 1199 u kërkonte të gjitha palëve që të ndalnin

menjëherë veprimet luftarake dhe të zbatonin një armëpushim në Kosovë, u bënte thirrje udhëheqësve të RFJ-së dhe të shqiptarëve të Kosovës që të fillonin menjëherë një dialog të njëmendtë, si dhe nxiste dërgimin e vëzhguesve ndërkombëtarë. Në tetor 1998, u nënshkruan disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat parashihnin, ndër të tjera, një armëpushim, tërheqjen e pjeshme të forcave të RFJ-së nga Kosova dhe dërgimin e vëzhguesve ndërkombëtarë. Pavarësisht nga kjo, provokimet dhe luftimet vazhduan. Në dhjetor 1998, UÇK-ja shpalli se më 1999 do të rifillonte plotësisht veprimet e armatosura.

24. Në fillim të shkurtit 1999, në Rambuje të Francës u organizua një konferencë ndërkombëtare për paqe. Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit 1999, forcat e RFJ-së filluan një varg ofensivash të mëtejshme. Bisedimet e paqes dështuan në mes të marsit 1999.

25. Më 24 mars 1999, forcat e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior ('NATO') filluan bombardimet ajrore kundër caqeve në Kosovë dhe Serbi. Si pasojë, dhe për shkak të operacioneve në shkallë të gjerë të forcave të RFJ-së, ushtarë të UÇK-së dhe një numër shumë i madh civilësh shqiptarë të Kosovës shkuan nga Kosova në Shqipëri, ku UÇK-ja kishte tashmë objekte dhe personel të saj.

26. Më 2 prill 1999, u shpall publikisht përbërja e QPK-së, diskutimet për krijimin e së cilës kishin nisur që në Rambuje. Sikurse u paraqit më lart, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI, Jakup KRASNIQI** dhe zyrtarë të tjerë të lartë të UÇK-së morën poste të rëndësishme në QPK.

27. Më 9 qershor 1999, autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë nënshkruan Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake me NATO-n. Marrëveshja parashikonte armëpushim të menjëhershëm dhe tërheqjen e plotë të forcave të RFJ-së nga Kosova deri më 20 qershor 1999. Më 10 qershor 1999, NATO-ja pezulloi fushatën e bombardimeve ajrore. Më të njëjtën ditë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së nxori Rezolutën 1244, me anë të së cilës kërkonte armëpushim si edhe vendosjen në Kosovë të pranive civile dhe të sigurisë në kuadër të Kombeve të Bashkuara për të parandaluar rifillimin e luftimeve, për të

zbatuar armëpushimin, si dhe për të siguruar tërheqjen e forcave të RFJ-së dhe çmilitarizimin e UÇK-së. Forcat nën drejtimin e NATO-s për Kosovën ('KFOR') filluan të dislokoheshin në Kosovë prej datës 12 qershor 1999.

28. Me tërheqjen e forcave të RFJ-së nga Kosova, një numër i madh ushtarësh të UÇK-së dhe refugjatësh shqiptarë të Kosovës u kthyen nga Shqipëria dhe u vendosën në zona që më parë kishin qenë nën kontrollin e forcave të RFJ-së. Anëtarë të UÇK-së dhe QPK-së filluan menjëherë të merrnin në kontroll institucione shtetërore, ndërtesa, si ndërtesat e komunave, ish-stacione të MPB-së dhe ndërmarrje, si dhe të vinin territorin nën kontrollin e tyre.

29. Më 20 qershor 1999, KFOR-i njoftoi tërheqjen e plotë të forcave të RFJ-së nga Kosova. Më 21 qershor 1999, UÇK-ja kishte nënshkruar tashmë një marrëveshje me KFOR-in, ndër të tjera, për ndalimin e të gjitha veprimeve luftarake ose provokuese dhe për përfundimin e fazave të procesit të çmilitarizimit brenda 90 ditësh. Forcat e RFJ-së dhe të UÇK-së i shkelën kushtet e rezolutave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare gjatë gjithë verës 1999, duke vazhduar me veprime luftarake dhe provokuese dhe duke bërë që të vazhdonte të ekzistonte rreziku real për rifillimin e luftimeve të armatosura.

30. Më 20 shtator 1999, UÇK-ja u çmilitarizua.

31. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e paraqitura në këtë aktakuzë si krime lufte u kryen në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe kishin lidhje me këtë konflikt ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së. Krimet u kryen në, ose në lidhje me bazat dhe shtabet e UÇK-së, dhe/ose gjatë veprimtarive të UÇK-së. Viktimat ishin persona që nuk merrnin pjesë aktive në luftime. Anëtarët dhe instrumentet e NKP-së kishin dijeni për rrethanat faktike që vërtetonin ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave.

Format e përgjegjesisë penale

Ndërmarrje kriminale e përbashkët dhe ndihmë e inkurajim

32. Së paku midis marsit 1998 deri në shtator 1999, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI, Jakup KRASNIQI** dhe anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë. Ndër këta kundërshtarë përfshiheshin persona që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione shtetërore të RFJ-së, ose që (b) ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët persona të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera (bashkërisht, 'kundërshtarët'). Ky qëllim i përbashkët përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të personave.

33. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI** kishin qëllimin e përbashkët të kryerjes së secilit prej krimeve të paraqitura në këtë aktakuzë së bashku me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët.

34. Si alternativë, për disa nga krimet që nuk ishin pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët, ishte e parashikueshme që ato mund të kryheshin nga një ose më shumë anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ose nga persona të përdorur nga cilido anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët për kryerjen e krimeve të përfshira në qëllimin e përbashkët. Duke pasur dijeninë që krime të tilla ishin pasojë e mundshme e zbatimit të qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI** morën pjesë në atë ndërmarrje dhe, rrjedhimisht, e morën përsipër atë rrezik me vullnet të lirë.

35. Ndër anëtarët e tjerë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ishin Azem SYLA, Lahi BRAHIMAJ, Fatmir LIMAJ, Sylejman SELIMI, Rrustem MUSTAFA, Shukri BUJA, Latif GASHI dhe Sabit GEÇI, si dhe disa udhëheqës të tjerë politikë dhe ushtarakë të UÇK-së dhe QPK-së, ndër të cilët edhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm; ministra dhe zëvendësministra të QPK-së; komandantë të zonave të UÇK-së, zëvendëskomandantë të zonave dhe anëtarë të tjerë të shtabeve të komandave të zonave; komandantë të brigadave dhe njësiteve; komandantë dhe anëtarë të shërbimeve policore dhe të zbulimit të UÇK-së dhe QPK-së; ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe zyrtarë të tjerë të QPK-së; si dhe të tjerë që vepronin në emër të UÇK-së dhe QPK-së (së bashku me **Hashim THAÇIN**, **Kadri VESELIN**, **Rexhep SELIMIN** dhe **Jakup KRASNIQIN**, bashkërisht, 'anëtarët e NKP-së'). Të gjithë këta individë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kontribuan në arritjen e qëllimit të përbashkët. Si alternativë, disa ose të gjithë këta individë nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, por u përdorën nga anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (së bashku me anëtarët e NKP-së, bashkërisht 'anëtarët dhe instrumentet e NKP-së').

36. Që prej vitit 1994 e më tej, dhe gjatë gjithë periudhës së aktakuzës, deklarata të ndryshme publike të Shtabit të Përgjithshëm morën përgjegjësinë për, përkrahën, legjitimuan dhe nxitën sulmet ndaj kundërshtarëve dhe vrasjen e tyre, si edhe kërcënuan hapur kundërshtarë të tjerë me të njëjtin fat. Kundërshtarët u shpallën 'tradhtarë' dhe 'bashkëpunëtorë' që duheshin 'ndëshkuar' dhe trajtuar 'pa mëshirë'. Njëkohësisht, përmes deklaratave publike dhe veprimeve në terren, si frikësimi, denigrimi dhe eliminimi i kundërshtarëve, përfshirë edhe përmes vrasjes, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kërkuan të pozicionoheshin si i vetmi zë dhe si të vetmit përfaqësues legjitimë të shqiptarëve të Kosovës.

37. Anëtarë dhe instrumente të NKP-së, ndër të cilët edhe ata që kishin lidhje të ngushta me **Hashim THAÇIN**, **Kadri VESELIN**, **Rexhep SELIMIN** dhe **Jakup KRASNIQIN**, kishin role kyçe në strukturat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së.

Anëtarë dhe instrumente të NKP-së, ndër të cilët ata në strukturat e policisë ushtarake dhe të zbulimit, aktivisht identifikuan dhe vunë në shënjestër kundërshtarë, duke i rrëmbyer, marrë në pyetje dhe keqtrajtuar ata. Së paku që prej prillit 1998 dhe duke vazhduar gjatë gjithë periudhës së aktakuzës, anëtarë të UÇK vunë në funksionim qendra në të cilat, ose rreth të cilave, qindra kundërshtarë u mbajtën të ndaluar, u keqtrajtuar dhe/ose u vranë nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së.

38. Rrëmbimet, ndalimet, keqtrajtimet dhe vrasjet e kryera nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së dihehin dhe raportoheshin gjerësisht, duke bërë që në një numër rastesh anëtarë të familjes, individë dhe organizata ndërkombëtare, ose persona të tjerë, të ndërhyjnë për të marrë vesh vendndodhjen e viktimave dhe/ose për të siguruar lirin e tyre.

39. Anëtarë dhe instrumente të NKP-së, ndër të cilët **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI**, si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, lëshuan direktiva, udhëzime dhe urdhra lidhur me kundërshtarët. Ky fokus tek kundërshtarët pasqyrohej gjithashtu edhe në disa nga rregulloret e brendshme, trajnimet, dokumentet e politikave dhe broshurat informuese të miratuara ose të lëshuara nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nivele të tjera të komandës së UÇK-së/QPK-së.

40. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI** ishin personalisht pjesëmarrës në trajtimin e kundërshtarëve në terren, ndër të tjera edhe përmes pjesëmarrjes së tyre në frikësimin, marrjen në pyetje, keqtrajtimin dhe mbajtjen të ndaluar të kundërshtarëve, si në rastet që diskutohen në vijim.

41. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

42. Në korrik 1998, menjëherë pas sulmeve të njësiteve të UÇK-së mbi Rahovecin dhe fshatrat përreth, gjatë të cilit u morën rob civilë serbë, një numër anëtarësh të Shtabit të Përgjithshëm, ndër të cilët **Hashim THAÇI, Kadri VESELI** dhe **Rexhep SELIMI**, ishin të pranishëm aty afër duke marrë pjesë në operacione dhe duke bërë

bashkërendimin e tyre. Pasi transferimit të disa të ndaluarve që ishin rrëmbyer në Rahovec, rrethina, dhe në vende të tjera, në ish-stacionin e policisë në Malishevë në fund të korrikut 1998, **Jakup KRASNIQI** u identifikua se ishte i pranishëm atje dhe në një rast vizitoi dhomën ku mbaheshin të ndaluarit.

43. [REDAKTUAR]. Në një numër rastesh, përfshirë edhe në fillim të shtatorit 1998 në zonën operative të Dukagjinit, **Hashim THAÇI** dhe **Rexhep SELIMI** ndërmorën hapa për të frikësuar dhe për të vendosur pushtetin e tyre mbi njësitet që kishin lidhje me LDK-në, ndër të cilat edhe Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës ('FARK') të lidhura me qeverinë në mërgim.

44. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] ishin të pranishëm si në vendin e arrestimit në [REDAKTUAR], ashtu edhe në [REDAKTUAR], ku të ndaluarit u transferuan, rrahën dhe morën në pyetje më pas. Në kuadër të kësaj ngjarjeje, pasi anëtarët [REDAKTUAR] ishin rrahur keq dhe kishin lëndime të dukshme, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i morën ata në pyetje, duke u kërkuar ndër të tjera që [REDAKTUAR]. Para se të liroheshin, [REDAKTUAR] u ktheu të ndaluarve letërnjoftimet. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

45. Në tetor 1998, në Jabllanicë, **Rexhep SELIMI** kërcënoi [REDAKTUAR], duke e akuzuar se kishte kritikuar UÇK-në.

46. [REDAKTUAR].

47. Në 1999, **Kadri VESELI**, **Rexhep SELIMI** dhe **Jakup KRASNIQI** u përfshinë në aspekte të ndryshme të transferimit, ndalimit dhe/ose lirimit të të ndaluarve që mbaheshin në një qendër ndalimi afër Kleçkës. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

48. Gjithashtu, **Hashim THAÇI**, gjatë ushtrimit të funksioneve të përshkruara në paragrafin 2 më lart, kontribuoi në mënyrë të qenësishme në arritjen e qëllimit të përbashkët, që përfshinte kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë, përmes një ose më shumë prej mënyrave në vijim:

- a. formulimit dhe/ose pjesëmarrjes në hartimin, miratimin, promovimin, shpërndarjen dhe zbatimin e planeve, politikave dhe praktikave për realizimin e qëllimit të përbashkët, ndër të tjera edhe në formën e komunikatave, deklaratave publike, rregulloreve të brendshme, strukturave dhe mekanizmave për mbledhjen dhe raportimin e informatave;
- b. pjesëmarrjes, lehtësimit, lejimit, dhe inkurajimit dhe/ose ndryshe ndihmimit të krimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët;
- c. mosmarrjes së masave të mjaftueshme për parandalimin dhe hetimin e krimeve dhe/ose ndëshkimit ose disiplinimit të kryesve;
- d. përhapjes dhe/ose lehtësimit të përhapjes së informacionit që synonte avancimin e qëllimit të përbashkët, shkaktimin e frikës, mosbesimit dhe urrejtjes ndaj kundërshtarëve, ndër të tjera edhe përmes komunikatave, deklaratave publike dhe mjeteve të tjera;
- e. bashkërendimit, përfshirjes në përpjekjet, dhe/ose mundësit të përpjekjeve për të mos dhënë informata ose për t'u dhënë informata të rreme, të paplota ose çorientuese komunitetit ndërkombëtar, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikut, ndër të tjera edhe lidhur me veprimtaritë kriminale të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së dhe zbatimin e pretenduar të së drejtës humanitare ndërkombëtare prej UÇK-së/QPK-së;
- f. emërimit, ngritjes në detyrë dhe/ose miratimit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së, përfshirë edhe të personave për të cilët pretendohet se ishin përfshirë në krime të rënda në të shkuarën;
- g. sigurimit, organizimit dhe/ose lehtësimit të mbështetjes politike, logjistike, ushtarake dhe/ose financiare, duke përfshirë edhe për anëtarë dhe

instrumente të NKP-së që kryenin krime për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe

h. bashkërendimit dhe mbajtjes së lidhjeve midis anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së për realizimin e qëllimit të përbashkët.

49. Gjithashtu, **Kadri VESELI**, gjatë ushtrimit të funksioneve të përshkruara në paragrafin 5 më lart, kontribuoi në mënyrë të qenësishme në arritjen e qëllimit të përbashkët, që përfshinte kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë, përmes një ose më shumë prej mënyrave në vijim:

- a. formulimit dhe/ose pjesëmarrjes në hartimin, miratimin, promovimin, shpërndarjen dhe zbatimin e planeve, politikave dhe praktikave për realizimin e qëllimit të përbashkët, ndër të tjera edhe në formën e komunikatave, deklaratave publike, rregulloreve të brendshme, strukturave dhe mekanizmave për mbledhjen dhe raportimin e informatave;
- b. pjesëmarrjes, lehtësimit, lejimit, dhe inkurajimit dhe/ose ndryshe ndihmimit të krimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët;
- c. mosmarrjes së masave të mjaftueshme për parandalimin dhe hetimin e krimeve dhe/ose ndëshkimin ose disiplinimin e kryesve;
- d. përhapjes dhe/ose lehtësimit të përhapjes së informacionit që synonte avancimin e qëllimit të përbashkët, shkaktimin e frikës, mosbesimit dhe urrejtjes ndaj kundërshtarëve, ndër të tjera edhe përmes komunikatave, deklaratave publike dhe mjeteve të tjera;
- e. emërimit, ngritjes në detyrë dhe/ose miratimit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së, përfshirë edhe të personave për të cilët pretendohet se ishin përfshirë në krime të rënda në të shkuarën;

- f. sigurimit, organizimit dhe/ose lehtësimit të mbështetjes politike, logjistike, ushtarake dhe/ose financiare, duke përfshirë edhe për anëtarë dhe instrumente të NKP-së që kryenin krime për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe
- g. bashkërendimit dhe mbajtjes së lidhjeve midis anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së për realizimin e qëllimit të përbashkët.

50. Gjithashtu, **Rexhep SELIMI**, gjatë ushtrimit të funksioneve të përshkruara në paragrafin 8 më lart, kontribuoi në mënyrë të qenësishme në arritjen e qëllimit të përbashkët, që përfshinte kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë, përmes një ose më shumë prej mënyrave në vijim:

- a. formulimit dhe/ose pjesëmarrjes në hartimin, miratimin, promovimin, shpërndarjen dhe zbatimin e planeve, politikave dhe praktikave për realizimin e qëllimit të përbashkët, ndër të tjera edhe në formën e komunikatave, deklaratave publike, rregulloreve të brendshme, strukturave dhe mekanizmave për mbledhjen dhe raportimin e informatave;
- b. pjesëmarrjes, lehtësimit, lejimit, dhe inkurajimit dhe/ose ndryshe ndihmimit të krimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët;
- c. mosmarrjes së masave të mjaftueshme për parandalimin dhe hetimin e krimeve dhe/ose ndëshkimin ose disiplinimin e kryesve;
- d. përhapjes dhe/ose lehtësimit të përhapjes së informacionit që synonte avancimin e qëllimit të përbashkët, shkaktimin e frikës, mosbesimit dhe urrejtjes ndaj kundërshtarëve, ndër të tjera edhe përmes komunikatave, deklaratave publike dhe mjeteve të tjera;
- e. emërimit, ngritjes në detyrë dhe/ose miratimit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së, përfshirë edhe të

personave për të cilët pretendohej se ishin përfshirë në krime të rënda në të shkuarën;

- f. sigurimit, organizimit dhe/ose lehtësimit të mbështetjes politike, logjistike, ushtarake dhe/ose financiare, duke përfshirë edhe për anëtarë dhe instrumente të NKP-së që kryenin krime për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe
- g. bashkërendimit dhe mbajtjes së lidhjeve midis anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së për realizimin e qëllimit të përbashkët.

51. Gjithashtu, **Jakup KRASNIQI**, gjatë ushtrimit të funksioneve të përshkruara në paragrafin 11 më lart, kontribuoi në mënyrë të qenësishme në arritjen e qëllimit të përbashkët, që përfshinte kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë, përmes një ose më shumë prej mënyrave në vijim:

- a. formulimit dhe/ose pjesëmarrjes në hartimin, miratimin, promovimin, shpërndarjen dhe zbatimin e planeve, politikave dhe praktikave për realizimin e qëllimit të përbashkët, ndër të tjera edhe në formën e komunikatave, deklaratave publike, rregulloreve të brendshme, strukturave dhe mekanizmave për mbledhjen dhe raportimin e informatave;
- b. pjesëmarrjes, lehtësimit, lejimit, dhe inkurajimit dhe/ose ndryshe ndihmimit të krimeve për realizimin e qëllimit të përbashkët;
- c. mosmarrjes së masave të mjaftueshme për parandalimin dhe hetimin e krimeve dhe/ose ndëshkimit ose disiplinimit të kryesve;
- d. përhapjes dhe/ose lehtësimit të përhapjes së informacionit që synonte avancimin e qëllimit të përbashkët, shkaktimin e frikës, mosbesimit dhe urrejtjes ndaj kundërshtarëve, ndër të tjera edhe përmes komunikatave, deklaratave publike dhe mjeteve të tjera;

- e. bashkërendimit, përfshirjes në përpjekjet, dhe/ose mundësimin të përpjekjeve për të mos dhënë informata ose për t'u dhënë informata të rreme, të paplota ose çorientuese komunitetit ndërkombëtar, vëzhguesve dhe publikut, ndër të tjera edhe lidhur me veprimtaritë kriminale të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së dhe zbatimin e pretenduar të së drejtës humanitare ndërkombëtare prej UÇK-së/QPK-së;
- f. emërimit, ngritjes në detyrë dhe/ose miratimit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së, përfshirë edhe të personave për të cilët pretendohet se ishin përfshirë në krime të rënda në të shkuarën;
- g. sigurimit, organizimit dhe/ose lehtësimit të mbështetjes politike, logjistike, ushtarake dhe/ose financiare, duke përfshirë edhe për anëtarë dhe instrumente të NKP-së që kryenin krime për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe
- h. bashkërendimit dhe mbajtjes së lidhjeve midis anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së për realizimin e qëllimit të përbashkët.

52. Përmes këtyre veprimeve dhe mosveprimeve, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** dhanë ndihmë praktike, inkurajim dhe/ose mbështetje morale, që patën ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të paraqitura në këtë aktakuzë. Ata ishin të vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së këtyre krimeve dhe për gjasën se veprimet dhe mosveprimet e tyre mund të kontribuonin në kryerjen e këtyre krimeve.

Përgjegjësia eprorë

53. Sikurse u përshkrua më lart, së paku që nga marsi 1998, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe ndër zyrtarët më të lartë në UÇK dhe/ose QPK. Në këto cilësi dhe

në bazë të pushtetit të tyre *de facto* si figura të larta udhëheqëse në UÇK dhe QPK, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** kishin secili kontroll efektiv mbi anëtarët dhe instrumentet e NKP-së që kryen krimet e paraqitura në këtë aktakuzë. Termi 'kryen', i përdorur në kontekstin e përgjegjësisë eprore, përfshin të gjitha format e përgjegjësisë penale sipas nenit 16(1) të Ligjit.

54. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI**, dinin ose kishin arsye të dinin, përmes burimeve të shumta, se persona nën kontrollin efektiv të tyre ishin në prag të kryerjes ose kishin kryer krime, ndër të tjera përmes:

- a. përfshirjes së tyre në përgatitjen, projektimin dhe/ose kryerjen e krimeve të tilla;
- b. pranisë së tyre në vendet ku u kryen krimet;
- c. marrjes prej tyre të informacionit për kryerjen e këtyre krimeve; dhe/ose
- d. shikimit personalisht prej tyre të provave të kryerjes së këtyre krimeve.

55. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** nuk morën masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar kryerjen e krimeve të paraqitura në këtë aktakuzë nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së nën kontrollin efektiv të tyre dhe/ose nuk i ndëshkuan kryesit e këtyre krimeve. Veprimet dhe mosveprimet e **Hashim THAÇIT, Kadri VESELIT, Rexhep SELIMIT dhe Jakup KRASNIQIT** të renditura në vijim tregojnë për mosmarrjen e këtyre masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej tyre:

- a. mosurdhërimi ose mosnjsja e hetimeve të mirëfillta dhe të mjaftueshme, ose mosmarrja e masave të tjera të mirëfillta dhe të mjaftueshme për të trajtuar pretendimet për kryerjen e krimeve nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së;
- b. mosraportimi prej tyre tek autoritetet përkatëse i informatave për kryerjen, ose kryerjen e mundshme, të krimeve nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së;

- c. mosmarrja e masave disiplinore, mospërgjashtimi ose mosulja në përgjegjësi e anëtarëve dhe instrumenteve të NKP-së që ishin përfshirë në kryerjen e krimeve dhe/ose që nuk parandaluan ose ndëshkuan kryerjen e krimeve nga vartësit e tyre;
- d. mosnxjerrja prej tyre e urdhrave që ishin të nevojshëm dhe të arsyeshëm në ato rrethana për të ndaluar ose për t'i dhënë fund kryerjes së krimeve nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së; dhe/ose
- e. mosmarrja prej tyre e masave të tjera të mjaftueshme, ndër të tjera edhe për sigurimin e trajnimit të duhur dhe për vendosjen e rregulloreve dhe procedurave të nevojshme, për të siguruar që anëtarë dhe instrumente të NKP-së të mos kryenin krime.

Krimet

56. Sikurse u paraqit në paragrafët 17, 31, 33-34, 52 dhe 54 më lart, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** kishin synimin dhe dijeninë e nevojshme për secilin prej krimeve që përshkruhen në vijim.

Përndjekje

57. Gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarët dhe instrumentet e NKP-së kryen një fushatë përndjekjesh të kundërshtarëve, duke përfshirë edhe në një numër komunash të Kosovës dhe në rrethet e Kukësit dhe Hasit në Shqipërinë Veriore. Veprimet përndjekëse që përshkruhen në vijim janë shembuj të një fushate më të gjerë të përndjekjes së kundërshtarëve që u zbatua në të gjithë Kosovën para, gjatë dhe pas periudhës së aktakuzës.

58. Përndjekja u krye për arsye politike dhe/ose etnike, ndër të tjera edhe përmes:

- a. arrestimeve ose ndalimeve të paligjshme dhe arbitrare, sikurse pretendohet në paragrafët 59-93;

- b. kushteve çnjerëzore në qendrat e ndalimit, sikurse pretendohet në paragrafët 94-134;
- c. zhdukjes me forcë të personave, sikurse pretendohet në paragrafin 171;
- d. keqtrajtimit dhe dhunës fizike dhe psikologjike, sikurse pretendohet në paragrafët 94-134;
- e. torturës, sikurse pretendohet në paragrafin 135;
- f. vrasjeve, sikurse pretendohet në paragrafët 136-170;
- g. dhënies së paligjshme të dënimeve kundër personave në qendrat e ndalimit ose në, apo në lidhje me, qendrat e ndalimit, ndër të cilat edhe ato të identifikuar në Listën A;
- h. përvetësimit të gjësendeve personale të personave në, apo në lidhje me, qendrat e ndalimit, përfshirë edhe ato të identifikuar në Listën A; dhe/ose
- i. vendosjes dhe mbajtjes së masave të tjera kufizuese dhe diskriminuese, ndër të cilat kontrollet arbitrare, marrja e deklaratave ose pranimeve të fajësisë nën shtrëngim ose detyrim, frikësimi dhe ngacmimi.

Burgosje/Arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar

59. Gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarë dhe instrumente të NKP-së u hoqën lirinë personave pa proces ligjor të rregullt, si në qendrat për ndalime afatgjata ashtu edhe në ato për ndalime afatshkurtra, në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore, duke përfshirë edhe ato të identifikuar në Listën A dhe që përshkruhen më tej në paragrafët vijues. Disa persona u transferuan nga një ose më shumë qendra ndalimi në qendra të tjera brenda Kosovës, ose nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas. Të ndaluarit u mbajtën nën masa kufizuese, ruheshin me roja në mjedise të kyçura dhe në kushte të shtrëngimit, dhe ishin objekt i akteve çnjerëzore, trajtimit mizor dhe torturës, sikurse përshkruhet në vijim. Këta persona u arrestuan dhe mbajtën të

ndaluar pa bazë ligjore, nuk u informuan për arsyen e arrestimit ose të ndalimit të tyre dhe/ose nuk iu dha mundësia të bënin ankesë kundër arsyeve të ndalimit të tyre.

Likoc

60. Së paku midis prillit 1998 dhe janarit 1999, Sylejman SELIMI, komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sabit GECI dhe një numër anëtarësh të tjerë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 25 persona për periudha të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në ish-stacionin e policisë dhe në disa vende të tjera në Likoc, Skënderaj. Të ndaluarit u mbajtën të lidhur dhe nën rojë në qeli të errëta dhe të kyçura, me dritare me shufra hekuri. Disa nga të ndaluarit në Likoc u mbajtën të ndaluar edhe në qendra të tjera ndalimi.

Jabllanicë

61. Së paku midis prillit 1998 dhe fundit të korrikut 1998, në Jabllanicë, Gjakovë, kishte një shtab të UÇK-së nën komandën e Lahi BRAHIMAJT. Lahi BRAHIMAJ dhe një numër anëtarësh të tjerë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 13 persona për periudha kohe të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në një kompleks në Jabllanicë që shërbente edhe si kazermë. Të ndaluarve iu konfiskuan dokumentet dhe gjësendet personale. Ata u lidhën me litar dhe tel dhe ruheshin me roja.

Llapushnik

62. Afërsisht midis fundit të prillit 1998 dhe 25 ose 26 korrikut 1998, disa anëtarë të UÇK-së vunë në funksionim një qendër ndalimi në një kompleks të ndarë me rrethojë në Llapushnik, Drenas (Glllogoc). Gjatë periudhës së lartpërmendur, në çfarëdo momenti të caktuar, në Llapushnik mbaheshin të ndaluar pa proces ligjor të rregullt deri në 30 persona. Të ndaluarit, të cilët u mbajtën për periudha të ndryshme, u lidhën me zinxhirë dhe ruheshin me roja. Disa të ndaluar në Llapushnik u transferuan aty prej qendrave të tjera të ndalimit. Një numër anëtarësh të UÇK-së,

ndër të cilët Fatmir LIMAJ dhe Shukri BUJA, morën pjesë në arrestimin dhe ndalimin e personave të mbajtur në Llapushnik.

Drenoc

63. Afërsisht midis majit dhe korrikut 1998, së paku 38 persona u mbajtën të ndaluar dhe nën rojë të armatosur për periudha të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në një shtab të UÇK-së në Drenoc, Rahovec, përfshirë edhe në një ish-ndërtesë shkolle dhe një ish-zyrë regjistrimi. Disa të ndaluar në Drenoc u transferuan në ose nga qendra të tjera, ndër të cilat edhe Malisheva.

64. [REDAKTUAR].

Malishevë

65. Duke filluar nga 17 korriku 1998, ose rreth kësaj date dhe gjatë ditëve në vijim, persona që ishin arrestuar dhe ndaluar në vende të tjera, duke përfshirë në Rahovec, zonat përreth, dhe Drenoc, u transportuan nga disa anëtarë të UÇK-së në ish-stacionin e policisë në Malishevë. Disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar në ish-stacionin e policisë të paktën 48 persona për periudha të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt deri më 26 ose 27 korrik 1998, ose rreth këtyre datave. Të ndaluarit u mbajtën në qeli të kyçura dhe nën rojë.

[REDAKTUAR]

66. Në ose rreth [REDAKTUAR] 1998, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku pesë persona pa proces ligjor të rregullt në bodrumin e një shtabi të UÇK-së në [REDAKTUAR], Prizren. Të ndaluarit u mbajtën në dhoma të kyçura dhe me dritare me shufra hekuri.

Bare dhe Bajgorë

67. Në gusht 1998, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku tetë persona në Bare, Podujevë, pa proces ligjor të rregullt dhe për periudha të ndryshme. [REDAKTUAR]. Midis gushtit 1998 dhe mesit të shtatorit 1998, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 16 persona në Bajgorë, Podujevë, pa proces ligjor të rregullt dhe për periudha të ndryshme. Disa të ndaluar në Bajgorë u transferuan nga ose për në vende të tjera, ndër të cilat edhe Bare. Barja dhe Bajgora ishin në Zonën Operative të Llapit, që ishte nën komandën e Rustem MUSTAFËS.

Llapashticë dhe vende të lidhura me të

68. Së paku midis nëntorit 1998 dhe marsit 1999, shtabi i Zonës Operative të Llapit ishte në Llapashticë, Podujevë. Komandanti i Zonës Operative të Llapit, Rustem MUSTAFA, Latif GASHI dhe disa anëtarë të tjerë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 52 persona pa proces ligjor të rregullt në një vend në Llapashticë, afër policisë ushtarake dhe shtabit të zonës. Ndaj të ndaluarve u përdorën masa kufizuese dhe ata u mbajtën në mjedise të kyçura me dritare me shufra hekuri.

69. Disa të ndaluar në Llapashticë ishin mbajtur më parë në vende të tjera. Që prej [REDAKTUAR] 1999 deri më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth këtyre datave, së paku një person u mbajt i ndaluar pa proces ligjor të rregullt në një shtab të UÇK-së [REDAKTUAR]. Pas kësaj ai u transferua në Llapashticë.

70. Nga Llapashtica, disa të ndaluar u transferuan në vende të tjera. Më 25 mars 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] të ndaluar u transferuan nga Llapashtica në Majac, Podujevë, dhe [REDAKTUAR] u transferuan nga Llapashtica në Potok, Podujevë. Ata u mbajtën të ndaluar në këto vende pa proces ligjor të rregullt deri më 7 prill 1999, ose rreth kësaj date.

[REDAKTUAR]

71. Rreth fundit të marsit 1999, disa anëtarë të UÇK-së të Zonës Operative të Llapit arrestuan një civil rom në ose rreth [REDAKTUAR], Podujevë, pas mbërritjes së tij nga një territor nën kontrollin e serbëve. Ai u lidh dhe u mbajt i ndaluar pa proces ligjor të rregullt për të paktën dy ditë në mes të fshatit, ku u rrah dhe ndaj tij u ushtrua dhunë.

Zllash

72. Në shtator 1998, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar [REDAKTUAR] pa proces ligjor të rregullt në një vend që përdorej nga anëtarë të UÇK-së në Zllash, Prishtinë. Midis afërsisht 1 dhe 19 prillit 1999, së paku shtatë persona u mbajtën të ndaluar pa proces ligjor të rregullt në një kompleks në Zllash që përdorej si bazë e sigurt dhe qendër për marrje në pyetje dhe ndalim nga anëtarët e njësitit gueril BIA në zonën operative të Llapit. Të ndaluarit u mbajtën nën rojë dhe nën masa kufizuese fizike, duke përfshirë edhe në një stallë të kyçur.

[REDAKTUAR]

73. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR], Skënderaj. Të ndaluarit u mbajtën nën rojë të armatosur [REDAKTUAR] dhe më pas, prej afërsisht [REDAKTUAR] 1998 deri afërsisht më [REDAKTUAR] 1998, në [REDAKTUAR]. Pas kësaj, të ndaluarit u çuan me automjet në një vend tjetër, ku u liruan. Gjatë kohës që ishin të ndaluar [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe ua ktheu përpara se të liroheshin.

[REDAKTUAR]

74. Midis [REDAKTUAR] 1998 dhe [REDAKTUAR] 1998, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku katër persona pa proces ligjor të rregullt dhe nën rojë në [REDAKTUAR], Lipjan, duke përfshirë edhe në [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

Gjatë transferimit nga dhe për në [REDAKTUAR], të ndaluarve iu lidhën sytë dhe duart.

Kleçkë dhe vende të lidhura me të

75. Së paku midis nëntorit 1998 dhe qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën 20 persona për periudha kohe të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në një shtëpi dhe ndërtesat përfaqësojnë saj afër Kleçkës, Lipjan. Të ndaluarit u lidhën, iu lidhën sytë, dhe u mbajtën nën rojë të armatosura. Në vitin 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët **Kadri VESELI, Rexhep SELIMI, Jakup KRASNIQI** dhe **Fatmir LIMAJ**, u përfshinë në aspekte të ndryshme të transferimit, ndalimit, dhe/ose lirimit të të ndaluarve të mbajtur në qendrën e ndalimit afër Kleçkës.

76. Disa të ndaluar në Kleçkë u transferuan nga ose për në qendra të tjera ndalimi. Rreth [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën një person pa proces ligjor të rregullt në [REDAKTUAR] të cilin më pas e transferuan në Kleçkë.

[REDAKTUAR]

77. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999 dhe [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku 13 persona pa proces ligjor të rregullt në [REDAKTUAR], Kaçanik, [REDAKTUAR]. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, pesë të ndaluar [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], Kaçanik, ku u mbajtën të ndaluar pa proces ligjor të rregullt. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] të pestë të ndaluarit [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], ku u mbajtën të ndaluar pa proces ligjor të rregullt deri më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date. Të ndaluarit në këto qendra u mbajtën nën masa kufizuese fizike dhe në dhoma të kyçura, dhe/ose nën rojë të armatosur. Në këto ndalime u përfshinë një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët anëtarë të [REDAKTUAR] në zonën

operative të Nerodimes. Komandant i Zonës Operative të Nerodimes ishte Shukri BUJA.

Cahan

78. Midis prillit dhe qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, mbajtën të ndaluar së paku 17 persona për periudha kohe të ndryshme në një dhomë në kazermën ushtarake të UÇK-së në Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri. Të ndaluarit u vunë nën masa kufizuese fizike dhe u mbajtën në një qeli të kyçur dhe/ose nën rojë të armatosur. Disa të ndaluar në Cahan u transferuan nga ose për në qendra të tjera të ndalimit të UÇK-së, [REDAKTUAR].

Kukës

79. Midis majit dhe qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI, mbajtën të ndaluar së paku 20 persona për periudha kohe të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në një ish-fabrikë metali në Kukës, rrethi i Kukësit, Shqipëri. Të ndaluarve iu konfiskuan dokumentet e udhëtimit dhe gjësendet personale. Ata u vunë nën pranga, u lidhën dhe u mbajtën nën rojë të armatosur në dhoma të kyçura dhe me dritare me shufra hekuri. Disa të ndaluar në Kukës u transferuan nga ose për në qendra të tjera ndalimi, [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

80. Që nga [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar së paku tre persona pa proces ligjor të rregullt në një shtab të UÇK-së në [REDAKTUAR], Malishevë. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së [REDAKTUAR] të ndaluar [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], afër [REDAKTUAR]. Të paktën shtatë persona u mbajtën të ndaluar në [REDAKTUAR] pa proces ligjor të rregullt deri më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date.

[REDAKTUAR]

81. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën [REDAKTUAR] pa proces ligjor të rregullt në një shtëpi në [REDAKTUAR], Drenas (Gllogoc). [REDAKTUAR] në një shtab të UÇK-së në një shtëpi në [REDAKTUAR], Drenas (Gllogoc), dhe në një vend në [REDAKTUAR], Drenas (Gllogoc), ku [REDAKTUAR] i ndaluar pa proces ligjor të rregullt deri rreth [REDAKTUAR] 1999. [REDAKTUAR] lidhur dhe nën rojë.

[REDAKTUAR]

82. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tre persona pa proces ligjor të rregullt në një vend në [REDAKTUAR] ose rreth saj, në Prishtinë. Të paktën dy prej tyre u mbajtën të ndaluar edhe në vende të tjera. Të ndaluarit u mbajtën nën rojë të armatosur dhe të lidhur.

[REDAKTUAR]

83. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999 dhe [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën nëntë persona për periudha kohe të ndryshme dhe pa proces ligjor të rregullt në një shtëpi në [REDAKTUAR], Viti. Të ndaluarit, disa prej të cilëve ua kishin mbuluar kokat, u mbajtën nën rojë dhe të lidhur.

Prizren

84. Afërsisht midis 15 qershorit 1999 dhe 23 qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tetë persona pa proces ligjor të rregullt në [REDAKTUAR] Prizrenit. [REDAKTUAR] të ndaluarit mbaheshin nën rojë. Disa të [REDAKTUAR] ishin mbajtur më parë të ndaluar në vende të tjera, përfshirë [REDAKTUAR].

85. Afërsisht midis 16 qershorit 1999 dhe 18 qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën 15 persona pa proces ligjor të rregullt tek ish-ndërtesa e

MPB-së në Prizren. Të ndaluarit u mbajtën nën rojë, me pranga në duar dhe të lidhur. Disa të ndaluar u transferuan nga ose për në vende të tjera, [REDAKTUAR].

86. Afërsisht midis 16 qershorit 1999 dhe 19 qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën dy persona në [REDAKTUAR], Prizren. Të ndaluarit u mbajtën në një dhomë të kyçur në një bodrum dhe iu vunë pranga në duar.

87. Më 26 qershor 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tre persona pa proces ligjor të rregullt në [REDAKTUAR] në Prizren.

Ferizaj

88. Afërsisht midis [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën një person pa proces ligjor të rregullt në një shtëpi në Ferizaj ose në rrethinë. Ai u mbajt në një dhomë të mbyllur, i lidhur dhe nën rojë.

[REDAKTUAR]

89. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën [REDAKTUAR] persona pa proces ligjor të rregullt në një shtëpi në [REDAKTUAR], Ferizaj. Të ndaluarit u mbajtën të lidhur dhe nën rojë.

Konvikti, Gjilan

90. Në fund të qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën tre persona pa proces ligjor të rregullt në një shtab të UÇK-së në një ish-shkollë me konvikt dhe në konviktin e saj në Gjilan.

Ish-stacioni i policisë në Suharekë

91. Në fund të qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së mbajtën të ndaluar të paktën një person pa proces ligjor të rregullt në ish-stacionin e policisë në Suharekë, para se

ta transferonin atë në vende të tjera, [REDAKTUAR]. Të ndaluarit iu konfiskuan dokumentet dhe gjësendet personale, [REDAKTUAR]. Gjatë kohës që mbahej i ndaluar në shtëpinë afër [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

Novobërdë

92. Në fund të qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së arrestuan të paktën katër persona pa proces ligjor të rregullt në [REDAKTUAR], Novobërdë, dhe i transferuan ata në një shtab të UÇK-së në [REDAKTUAR] në Novobërdë.

[REDAKTUAR]

93. Për rreth dy ose tri ditë në korrik ose gusht 1999, një i moshuar serb u mbajt i ndaluar pa proces ligjor të rregullt nga disa anëtarë të UÇK-së të Zonës Operative të Llapit në një bazë të UÇK-së në [REDAKTUAR], Prishtinë.

Akte të tjera çnjerëzore dhe trajtim mizor

94. Gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarë dhe instrumente të NKP-së krijuan dhe mbajtën kushte çnjerëzore në qendrat e ndalimit, ndër të cilat edhe ato të identifikuar në Listën A. Këto kushte karakterizoheshin nga heqja e lirisë pa proces ligjor të rregullt, sikurse përshkruhet më lart, si dhe nga ofrimi i pamjaftueshëm i ushqimit, ujit, kushteve higjienike e sanitare, shtrujave e mbulojave dhe strehimit, dhe kujdesit shëndetësor.

95. Gjithashtu, gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarë dhe instrumente të NKP-së rregullisht keqtrajtuan persona, qoftë fizikisht, ndër të tjera përmes rrahjeve dhe shkakimit të lëndimeve të rënda trupore përmes përdorimit të mjeteve të ndryshme, ashtu edhe psikologjikisht, ndër të tjera përmes kërcënimit me vdekje dhe lëndim të rëndë trupor, frikës, poshtërimit, diskriminimit për arsye politike dhe etnike, kanosjes, ngacmimeve, marrjes në pyetje dhe marrjes së deklaratave dhe deklaratave pranuese nën detyrim ose shtrëngim. Anëtarë dhe instrumente të NKP-së keqtrajtuan

persona para personave të tjerë, duke përfshirë edhe para të ndaluarve të tjerë. Aktet e keqtrajtimit fizike dhe psikologjike ndodhnin rregullisht në qendrat e ndalimit, rreth tyre, ose në lidhje me to, ndër të cilat edhe në ato të identifikuar në Listën A dhe të përshkruara më tej në paragrafët vijues, duke përfshirë edhe gjatë arrestimeve ose rrëmbimeve dhe transferimeve nga apo për në këto qendra.

96. Kur anëtarë të familjes apo njerëz të tjerë kërkonin informata lidhur me persona të arrestuar, të rrëmbyer, ose të ndaluar, anëtarë dhe instrumente të NKP-së shpesh refuzonin të përgjigjeshin, ose jepnin informata të rreme ose çorientuese. Gjithashtu, ata shpesh i refuzonin kërkesat për qasje në qendrat e ndalimit ose për të vizituar të ndaluarit, i kërcënonin ose keqtrajtonin fizikisht ata që kërkonin informata dhe nuk pyesnin apo hetonin për fatin ose vendndodhjen e personave të zhdukur.

Likoc

97. Afërsisht midis prillit 1998 dhe janarit 1999, të ndaluarve në Likoc, Skënderaj, nuk iu ofrua mjaftueshëm ushqim, ujë, kushte higjienike e sanitare, kujdes shëndetësor dhe/ose shtroja e mbuloja. Një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët Sylejman SELIMI dhe Sabit GEÇI, rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuuan ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me pushkë, shkopinj bejsbolli, instrumente prej metali dhe shkopinj druri, grushte, shkelma, dhe/ose ndryshe u kërcënuan me lëndime trupore dhe vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër që u bëhej të ndaluarve të tjerë, ndër të cilët edhe anëtarë të familjes, si dhe i detyruan të rrihnin njëri-tjetrin. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se ishin tradhtarë për arsye se përkrahnin LDK-në, se shoqëroheshin me serbë ose me punonjës policie, se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe se nuk përkrahnin UÇK-në. [REDAKTUAR].

Jabllanicë

98. Së paku midis prillit 1998 dhe fundit të korrikut 1998, të ndaluarve në Jabllanicë, Gjakovë, nuk iu ofrua mjaftueshëm ushqim, ujë, kushte higjienike e sanitare, kujdes shëndetësor dhe/ose shtroja e mbuloja. Të ndaluarve iu morën sendet personale të cilat nuk iu kthyen kurrë më. Një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët Lahi BRAHIMAJ, rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuan ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj bejsbolli, grushte, shkelma, [REDAKTUAR] dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë dhe, të paktën në një rast, i urdhëruan të vrisnin njëri-tjetrin. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin me serbë ose punonjës policie dhe se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe. Ndër të ndaluarit kishte romë, dhe persona me kombësi serbe, [REDAKTUAR].

Llapushnik

99. Afërsisht midis fundit të prillit dhe 25 ose 26 korrikut 1998, të ndaluarit në Llapushnik, Drenas (Gllogoc) u mbajtën kryesisht në një stallë lopësh me pleh në dysheme dhe me duhma të forta. Të ndaluarit flinin mbi dysheme dhe atyre iu ofruan kushte higjienike e sanitare, kujdes shëndetësor dhe/ose shtroja e mbuloja të pamjaftueshme. Të ndaluarve iu morën sendet personale dhe nuk iu kthyen kurrë më. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuan ata psikologjikisht. Të ndaluarit u lënduan me shkopinj, kondakë armësh dhe instrumente të tjera, si dhe u goditën me grushte dhe/ose shkelma. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Ata u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin me serbë ose romë, se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe mospërkrahës të UÇK-së. Ndër të ndaluarit kishte përkrahës të LDK-së dhe romë e serbë.

Drenoc

100. Midis majit dhe korrikut 1998, të ndaluarit në Drenoc, Rahovec, u mbajtën në qeli të improvizuara dhe nuk iu ofrua kujdes mjekësor i mjaftueshëm. Të ndaluarve iu morën sendet personale dhe nuk iu kthyen kurrë më. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me shkopinj, grushte, shkelma, iu lidh në trup rrymë elektrike, dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin me serbë ose romë, se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe mospërkrahës të UÇK-së. Ndër të ndaluarit kishte përkrahës të LDK-së dhe romë e serbë.

Malishevë

101. Afërsisht midis 17 korrikut 1998 dhe 26 ose 27 korrikut 1998, të ndaluarit në ish-stacionin e policisë në Malishevë u mbajtën në dhoma të tejmbushura, me shumë pak ajrim, dhe ushqimi, uji, kushtet higjienike e sanitare, kujdesi shëndetësor dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. **Jakup KRASNIQI** u identifikua se ishte i pranishëm në ish-stacionin e policisë dhe, në një rast, vizitoi dhomën ku mbaheshin të ndaluarit. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me kondakë pushkësh dhe mjete të tjera, u shkelmuan dhe/ose ndryshe u kërcënuan me vdekje dhe dhunë fizike. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Ndër të ndaluarit kishte përkrahës të LDK-së dhe romë e serbë.

[REDAKTUAR]

102. Në [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, në [REDAKTUAR], Prizren, disa anëtarë të UÇK-së i rrahën të ndaluarit egërsisht, përfshirë edhe me kondak pushke, si dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarve iu ofruan kushte strehimi të

pamjaftueshme dhe ata ishin dëshmitarë të gjendjes së të ndaluarve të tjerë pasi këta të ndaluar të tjerë ishin rrahur. Ndër të ndaluarit kishte persona që konsideroheshin të dyshimtë, ndër të tjera edhe për shkak të shoqërimit të tyre me serbë dhe me autoritetet serbe. Të paktën një i ndaluar u mor në pyetje në lidhje me të qenit spiun dhe iu tha se duhej të përkrahte UÇK-në.

Bare dhe Bajgorë

103. Midis gushtit 1998 dhe mesit të shtatorit 1998, të ndaluarit në Bare dhe Bajgorë, Podujevë u mbajtën në dhoma të tejmbushura dhe iu ofrua ushqim dhe/ose kujdes shëndetësor i pamjaftueshëm. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me pushkë, shufra dhe shkopinj, dhe me shkelma, grushte dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata panë dhe dëgjuan keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. [REDAKTUAR]. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin dhe bashkëpunonin me autoritetet serbe. Ndër të ndaluarit kishte të paktën një person me kombësi serbe.

Llapashticë dhe vendet e lidhura me të

104. Së paku midis nëntorit 1998 dhe marsit 1999, të ndaluarit në Llapashticë, Podujevë u mbajtën kryesisht në një stallë të tejmbushur, e përbërë vetëm nga një dhomë me ndriçim të dobët dhe pa ngrohje. Ushqimi, uji, kushtet higjienike e sanitare, kujdesi shëndetësor dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj, zinxhirë, litarë dhe kondakë pushkësh, me grushte, shkelma, me rrymë elektrike, dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë dhe u detyruan të rrihnin njëri-tjetrin. Disa të ndaluar u detyruan të kryenin punë krahu. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin me serbë, se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe, ose

se nuk e përkrahnin UÇK-në. Ndër të ndaluarit kishte anëtarë dhe përkrahës të LDK-së dhe persona me kombësi serbe.

105. Të paktën një i ndaluar u keqtrajtua në një vend tjetër përpara se të arrinte të Llapashticë. Që prej [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, deri më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, të paktën një i ndaluar, i cili më vonë u transferua në Llapashticë, u mbajt në [REDAKTUAR], ku ushqimi, uji, kushtet higjienike e sanitare dhe /ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan, ishin të pamjaftueshme. Disa anëtarë të UÇK-së e rrahën të ndaluarin egërsisht dhe e keqtrajtuat psikologjikisht. [REDAKTUAR]. I ndaluari, [REDAKTUAR], u mor në pyetje dhe akuzua se ishte anëtar i [REDAKTUAR], bashkëpunëtor i serbëve, si dhe për mosbashkëpunim ose mospërkrahje të UÇK-së.

Zllash

106. Në shtator 1998 dhe afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, të ndaluarve në Zllash, Prishtinë, nuk iu ofrua mjaftueshëm ushqim, ujë, kushte higjienike e sanitare, shtroja e mbuloja dhe/ose kujdes shëndetësor. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj bejsbolli, shkopinj dhe mjete të tjera, grushte, shkelma, u dogjën [REDAKTUAR], iu vu rrymë elektrike në trup, iu urinua sipër, [REDAKTUAR], dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se ishin anëtarë të LDK-së, tradhtarë, spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe ndryshe mospërkrahës të UÇK-së. [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

107. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u transferuan nga [REDAKTUAR], Skënderaj, në [REDAKTUAR]. Afërsisht midis [REDAKTUAR]

1998 dhe [REDAKTUAR] 1998, një numër anëtarësh të UÇK-së i rrahën egërsisht dhe keqtrajtuuan psikologjikisht të ndaluarit në [REDAKTUAR]. Të paktën gjashtë prej të ndaluarve u rrahën në të gjithë trupin me shkopinj, me shkelma, u shkelën sipër, u goditën me grushte dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë.

108. Pasi [REDAKTUAR] ishin rrahur keqas dhe kishin lëndime të dukshme, [REDAKTUAR] morën në pyetje [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

109. Midis [REDAKTUAR] 1998 dhe [REDAKTUAR] 1998, një numër anëtarësh të UÇK-së rrahën egërsisht dhe keqtrajtuuan psikologjikisht të paktën katër të ndaluar në [REDAKTUAR], Lipjan.

110. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

111. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] . [REDAKTUAR]. Gjatë mbajtjes në ndalim, një anëtar i UÇK-së i tha një prej të ndaluarve se do të dënohej me vdekje.

Kleçkë

112. Së paku midis nëntorit 1998 dhe qershorit 1999, të ndaluarit në Kleçkë, Lipjan u mbajtën, ndër të tjera, në bodrume me dysheme prej dheu, me mure me njolla gjaku, në kushte të këqija higjienike e sanitare dhe me kujdes mjekësor të pamjaftueshëm. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuuan ata psikologjikisht. Të ndaluarit, të cilëve ndonjëherë ua lidhnin sytë, u goditën me shkopinj, tuba dhe tela, shkelma, grushte dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se ishin policë serbë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe mospërkrahës të UÇK-së. Ndër të ndaluarit kishte edhe persona me kombësi serbe. [REDAKTUAR], në keqtrajtimin e të

ndaluarve në Kleçkë u përfshinë edhe një numër anëtarësh të tjerë të UÇK-së, ndër të cilët Fatmir LIMAJ.

113. Disa të ndaluar u keqtrajtuuan në vende të tjera, përpara se të arrinin në Kleçkë ose pas largimit nga Kleçka. Në [REDAKTUAR] 1999, disa anëtarë të UÇK-së morën në pyetje të paktën një të ndaluar në [REDAKTUAR], i cili u rrah egërsisht dhe u keqtrajtua psikologjikisht.

[REDAKTUAR]

114. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999 dhe [REDAKTUAR] 1999, të ndaluarit në [REDAKTUAR], Kaçanik dhe [REDAKTUAR] u mbajtën në qeli ndalimi të improvizuara, pa mbrojtje nga kushtet e motit, dhe ushqimi, uji, ngrohja dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuuan ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me armë automatike, [REDAKTUAR]. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit, [REDAKTUAR], u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin, bashkëpunonin ose ndihmonin serbët dhe autoritetet serbe.

Cahan

115. Midis prillit dhe qershorit 1999, të ndaluarit në Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri, u mbajtën në një qeli të improvizuar, të tejmbushur, të pambrojtur nga kushtet atmosferike, si shiu, temperaturat e ftohta, dhe duhma e një nevojtoje aty afër. Ushqimi, uji, kujdesi mjekësor, kushtet higjienike e sanitare dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuuan ata psikologjikisht, ndër të cilët Sabit GEÇI. Të ndaluarit u goditën me shkopinj gome, shkopinj, një shufër hekuri, një kamxhik, një patericë, me kondakë pushkësh dhe këpucë, [REDAKTUAR] dhe/ose ndryshe u kërcënuan me vdekje dhe dhunë. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u

akuzuan se ishin përkrahës dhe spiunë të LDK-së, se shoqëroheshin dhe bashkëpunonin me serbët dhe autoritetet serbe dhe se nuk përkrahnin UÇK-në. [REDAKTUAR].

Kukës

116. Midis majit dhe qershorit 1999, të ndaluarit në Kukës, rrethi i Kukësit, Shqipëri, u mbajtën në dhoma të nxehta dhe mbytëse, me dysheme të pista prej betoni. Ushqimi, uji, kushtet higjienike e sanitare, kujdesi shëndetësor dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GECI, rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj gome, shufra metali, armë dhe një shkop bejsbolli, u prenë me thika, u goditën me grushte, shkelma, u dogjën, [REDAKTUAR], u qëlluan me armë, ishin objekt i akteve të mbytjes së simuluar dhe/ose ndryshe u kërcënuan me lëndime trupore dhe vdekje. Disa anëtarë të UÇK-së i detyruan dy të ndaluar të [REDAKTUAR] dhe shtinë kundër tyre me armë automatike, duke i plagosur. Një i ndaluar u informua se ishte dënuar me burgim dhe ekzekutim, ndonëse nuk ishte mbajtur asnjë gjykim. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë, duke përfshirë edhe të anëtarëve të familjes dhe u urdhëruan të rrihnin njëri-tjetrin. Disa anëtarë të UÇK-së i detyruan të ndaluarit të kryenin punë krahu.

117. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se shoqëroheshin me serbë ose me punonjës policie dhe se ishin tradhtarë, spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe. [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

118. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, të ndaluarit në [REDAKTUAR], Malishevë, dhe në [REDAKTUAR], u mbajtën në qeli të improvizuara dhe të tejmbushura, [REDAKTUAR], dhe ushqimi, uji, kujdesi shëndetësor dhe/ose kushtet

higjienike e sanitare që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me shufra hekuri dhe shkopinj, me grushte, shkelma, dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë dhe u detyruan të kryenin punë krahu. Të paktën dy të ndaluar [REDAKTUAR]. Të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan se ishin anëtarë dhe përkrahës të LDK-së, spiunë dhe bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe mospërkrahës të UÇK-së.

[REDAKTUAR]

119. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht rrahën egërsisht dhe keqtrajtuat psikologjikisht [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], Drenas (Glllogoc). [REDAKTUAR] godit me kondakë pushkësh, stape, shkelma dhe u kërcënuan me vdekje. [REDAKTUAR], e fyen, i bënë pyetje për armë dhe për komandantët dhe policët serbë dhe e morën në pyetje dhe e akuzuan se kishte kryer krime kundër shqiptarëve të Kosovës.

[REDAKTUAR]

120. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, të ndaluarit në një vendndodhje afër [REDAKTUAR], Prishtinë, u mbajtën në qeli të improvizuara, [REDAKTUAR] dhe ushqimi, uji, kushtet higjienike e sanitare, dhe/ose shtrojat e mbulojat që iu ofruan atyre, ishin të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me një lopatë, pushkë, gypa gome dhe tuba, grushte e shkelma, dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Ata dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR]. Të ndaluarit, [REDAKTUAR], u fyen dhe morën në pyetje, dhe u akuzuan se kishin lidhje me autoritetet serbe, me punonjës të policisë dhe me bashkëpunëtorë.

[REDAKTUAR]

121. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, të ndaluarve në [REDAKTUAR], Viti nuk iu ofrua mjaftueshëm ushqim, ujë, kujdes mjekësor dhe kushte higjienike e sanitare. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Ata u goditën në të gjithë trupin me zinxhirë, shkopinj, me kondakë pushkësh, dërrasa, e shkelma, ishin objekt i ekzekutimeve të simuluar dhe/ose ndryshe u kërcënuan me dhunë dhe vdekje. [REDAKTUAR]. Të ndaluarit dëgjonin keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR]. Të ndaluarit, [REDAKTUAR], u fyen dhe u morën në pyetje, si dhe u akuzuan për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës dhe se kishin lidhje e bashkëpunonin me autoritetet serbe.

Prizren

122. Afërsisht midis 15 qershorit 1999 dhe 23 qershorit 1999, disa persona u mbajtën të ndaluar [REDAKTUAR] pa dritë në [REDAKTUAR] Prizrenit. Disa prej tyre u mbajtën [REDAKTUAR]. Të ndaluarve iu ofrua ushqim dhe shtroja e mbuloja të pamjaftueshme. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me stape, tuba, shkopinj, gypa gome, kondakë pushkësh dhe thika, grushte, shkelma, dhe/ose ndryshe u kërcënuan me dhunë dhe vdekje. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit u fyen dhe u morën në pyetje e akuzuan se ishin anëtarë të LDK-së, për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës, ose se ishin bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe. Ndër të ndaluarit kishte persona me kombësi serbe.

123. Afërsisht midis 16 qershorit 1999 dhe 18 qershorit 1999, të ndaluarve në ish-ndërtesën e MPB-së në Prizren nuk iu ofrua mjaftueshëm ushqim, ujë, kujdes mjekësor dhe kushte strehimi. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën në të gjithë

trupin me një shishe uji, shkopinj, stape, rripa dhe një armë automatike, me grushte e shkelma, dhe/ose ndryshe u kërcënuan me dhunë dhe vdekje. Një të ndaluar i ia shkulën dhëmbët me pincë. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë, [REDAKTUAR]. Të ndaluarit u fyen dhe u morën në pyetje e akuzuan për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës, se ishin spiunë ose bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe ndryshe mospërkrahës të UÇK-së. [REDAKTUAR].

124. Afërsisht midis 16 qershorit 1999 dhe 19 qershorit 1999, të ndaluarve në [REDAKTUAR] Prizren iu ofrua ushqim, ujë dhe/ose kujdes mjekësor i pamjaftueshëm. Një numër anëtarësh të UÇK-së rregullisht i rrahën të ndaluarit egërsisht dhe i keqtrajtuat ata psikologjikisht. Të ndaluarit u goditën me shkopinj dhe zinxhirë, grushte, shkelma dhe/ose ndryshe u kërcënuan me dhunë dhe vdekje. Dy të ndaluar, [REDAKTUAR] u morën në pyetje dhe u akuzuan për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës, se ishin spiunë ose bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe dhe se nuk i ishin bashkuar UÇK-së.

125. Më 26 qershor 1999, ose rreth kësaj date, të ndaluarit në [REDAKTUAR] Prizren u mbajtën në qeli të improvizuara, [REDAKTUAR], dhe në dhoma me mure të spërkatura me gjak. Një numër anëtarësh të UÇK-së i rrahën egërsisht dhe keqtrajtuat psikologjikisht të ndaluarit. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj, gypa gome, çekiçë, shkopinj gome dhe një zinxhir, u dogjën me cigare, u goditën me grushte e shkelma dhe/ose u kërcënuan me vdekje. Kur një i ndaluar kërkoi ujë, atë e detyruan të pinte hollues boje. Një anëtar i UÇK-së i urdhëroi dy të ndaluar të zhvisheshin dhe të bënin seks. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. Të ndaluarit, [REDAKTUAR], u morën në pyetje për përkatësinë etnike, armët, dhe lidhjet e tyre me serbët.

Rahovec

126. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, një numër anëtarësh të UÇK-së ushtruan dhunë fizike dhe psikologjike ndaj [REDAKTUAR] dhe bashkëshortes së tij që ishin me kombësi serbe, në shtëpinë e tyre në Rahovec. Një anëtar i UÇK-së e rrahu [REDAKTUAR] para bashkëshortes së tij, ndërkohë që të tjerët u morën gjësendet e tyre personale. Pasi e morën [REDAKTUAR], disa anëtarë të UÇK-së i vunë zjarrin shtëpisë së tij.

127. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, një numër anëtarësh të UÇK-së ushtruan dhunë fizike dhe psikologjike ndaj [REDAKTUAR] që ishin me kombësi serbe, [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], Rahovec. Disa anëtarë të UÇK-së e rrahën [REDAKTUAR] dhe i kërkuan armë. [REDAKTUAR] e dëgjoi dhe e pa rrahjen. Pasi morën disa armë, disa anëtarë të UÇK-së e morën [REDAKTUAR] me forcë.

128. Afërsisht midis [REDAKTUAR] 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së ushtruan dhunë fizike dhe psikologjike ndaj [REDAKTUAR] që ishin me kombësi serbe, në [REDAKTUAR] Rahovec. Pasi e arrestuan [REDAKTUAR], disa anëtarë të UÇK-së rrahën egërsisht [REDAKTUAR] dhe shkatërruan dhe morën gjësendet e tyre personale. Ngacmimet dhe keqtrajtimi vazhduan deri sa [REDAKTUAR] u larguan nga Kosova më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date.

Ferizaj

129. Afërsisht midis [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së rrahën egërsisht dhe keqtrajtuan psikologjikisht një të ndaluar në një shtëpi në Ferizaj ose afër tij. I ndaluari u rrah në të gjithë trupin, u godit me grushte e shkelma. Ai [REDAKTUAR] u mor në pyetje dhe akuzua se kishte kryer krime. [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

130. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, një numër anëtarësh të UÇK-së rrahën dhe keqtrajtuuan psikologjikisht të ndaluarit në [REDAKTUAR], Ferizaj. [REDAKTUAR] u godit me kondakë pushkësh, shkelma, grushte dhe u kërcënua me vdekje. [REDAKTUAR] dëgjoji kur i rrihnin personat e tjerë. Të ndaluarit [REDAKTUAR] u morën në pyetje lidhur me armët që mbanin të ndaluarit, të afërmit e tyre dhe persona të tjerë.

Konvikti, Gjilan

131. Në fund të qershorit 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së rrahën egërsisht dhe keqtrajtuuan psikologjikisht të ndaluarit në ish-shkollën me konvikt dhe në konviktin e saj në Gjilan. Të ndaluarit u goditën në të gjithë trupin me shkopinj dhe stape, shkelma, grushte, dhe/ose ndryshe u kërcënuan me dhunë dhe vdekje. Të ndaluarit dëgjuan dhe panë keqtrajtimin e egër të të ndaluarve të tjerë. [REDAKTUAR]. Të ndaluarit me kombësi serbe, u fyen dhe u morën në pyetje e u akuzuan për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës.

Ish-stacioni i policisë në Suharekë

132. Në fund të qershorit 1999, një numër anëtarësh të UÇK-së rrahën egërsisht dhe keqtrajtuuan psikologjikisht një të ndaluar në ish-stacionin e policisë në Suharekë. I ndaluari u godit me kondakë pushkësh, shkopinj gome dhe çizme. Disa anëtarë të UÇK-së i bënë pyetje lidhur me një komandant serb dhe e akuzuan për kryerje krimesh kundër shqiptarëve të Kosovës. Pas [REDAKTUAR], disa anëtarë të UÇK-së e lidhën të ndaluarin, ia mbuluan kokën dhe e transferuan në [REDAKTUAR]. Atë [REDAKTUAR] nuk i dhanë ushqim e ujë. Marrjet në pyetje vazhduan dhe atë e kërcënuan me vdekje nëse nuk pranonte.

Novobërdë

133. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, gjatë arrestimit të një personi serb [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] Novobërdë, disa anëtarë të UÇK-së i vunë atij një pistoletë në gojë, e shkelmuan dhe goditën, dhe e detyruan të hipte në një veturë. Pas kësaj atë e çuan në një shtab të UÇK-së aty afër [REDAKTUAR] në Novobërdë, ku e keqtrajtuan dhe rrahën egërsisht. I ndaluar [REDAKTUAR] u urdhëruan të dorëzonin armët e tyre. [REDAKTUAR] disa anëtarë të UÇK-së kërcënuan të ndaluarin dhe anëtarët e familjes së tij dhe u thanë se serbët duhet të shkatërrohen, të largohen, dhe/ose të hiqen prej aty.

134. Veprimet dhe mosveprimet e përshkruara në paragrafët 59 deri në 134 më lart, të marra veças ose së bashku, u shkaktuan vuajtje ose lëndime të rënda mendore dhe/ose fizike viktimave dhe/ose përbënin cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor. Këto veprime dhe mosveprime shkelën të drejtat themelore të viktimave për liri dhe siguri të personit, liri të lëvizjes, proces ligjor të rregullt dhe mosdiskriminim për arsye politike dhe etnike. Anëtarë dhe instrumente të NKP-së u përpoqën t'i detyronin viktimat të vepronin kundër vullnetit dhe ndërgjegjes së tyre. Si rezultat i trajtimit, viktimat humbën vetëdijen, pësuan thyerje të eshtrave dhe plagë të tjera të rënda, u poshtëruan, shfytyruan, u mbuluan në gjak dhe patën pasoja afatgjata psikologjike dhe fizike që vazhduan edhe pas veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart.

Torturë

135. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët 59-135 më lart, anëtarë dhe instrumente të NKP-së shkaktuan dhimbje ose vuajtje të rënda me qëllim marrjen e informatave ose deklaratave pranuese, ndëshkimin, frikësimin ose shtrëngimin e viktimës ose të një personi tjetër dhe/ose diskriminimin, ndër të tjera për arsye politike dhe etnike, të viktimës ose personi tjetër. Gjatë veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart dhe në lidhje me to, anëtarë dhe instrumente të

NKP-së i morën viktimat në pyetje, i shtrënguan dhe i detyruan të nënshkruanin deklaratat pranuese dhe të jepnin informata, si dhe i akuzuan se ishin kundërshtarë, duke i ndëshkuar, keqtrajtuar dhe trajtuar çnjerëzisht për këtë.

Vrasje e paligjshme

136. Gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarë dhe instrumente të NKP-së, përmes veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, shkaktuan vdekjen e personave në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore, ndër të tjera edhe pas arrestimeve dhe rrëmbimeve, si dhe në qendrat e ndalimit ose në lidhje to. Ndër to përfshihen vrasje të kryera gjatë trajtimit mizor dhe çnjerëzor dhe vdekje të shkaktuara si pasojë e trajtimit mizor e çnjerëzor në qendrat e ndalimit, ndër të cilat edhe ato të identifikuara në Listën A. Shembuj të tjerë vrasjesh nga anëtarë dhe instrumente të NKP-së ishin edhe ato që u kryen gjatë kohës së tërheqjes së UÇK-së nga këto qendra përballë ofensivës së forcave të RFJ-së. Persona të ndaluar u vranë gjatë ose rreth kohës së këtyre tërheqjeve, ndonjëherë pasi ishin transferuar fillimisht në një ose më shumë vende të tjera ndalimi. Incidente të vrasjeve përfshijnë ato të identifikuara në Listën B dhe që përshkruhen më tej në paragrafët në vijim.

Likoc

137. Në [REDAKTUAR] 1998, [REDAKTUAR] u rrëmbyen nga disa anëtarë të UÇK-së dhe u sollën [REDAKTUAR] në një vend përballë shtabit të UÇK-së në Likoc. Në kohën që [REDAKTUAR] po e lironin, një ushtar i UÇK-së e informoi atë se [REDAKTUAR] do t'i bashkohej më vonë. [REDAKTUAR] burrat u panë për herë të fundit të gjallë kur mbaheshin nga UÇK-ja. Personave që më pas kërkuan informacion për burrat e zhdukur, anëtarë të UÇK-së u thanë se ata po merreshin në pyetje. [REDAKTUAR], kufomat e [REDAKTUAR] burrave u gjetën [REDAKTUAR]. Kufomat kishin shenja rrahjeje dhe plagësh me armë zjarri.

138. [REDAKTUAR] u rrëmbye nga anëtarë me uniformë të UÇK-së në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1998 dhe u soll në Likoc. Kufoma e tij u gjet në [REDAKTUAR], me plagë të shumta nga armë zjarri.

139. [REDAKTUAR] u arrestua në janar 1999 dhe u soll në objektin e ndalimit të UÇK-së në Likoc. Anëtarë të familjes së tij bënë përpjekje të përsëritura për të marrë informata për statusin e [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] atyre u [REDAKTUAR] nuk u dhanë informata, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] u pa për herë të fundit kur mbahej nga UÇK-ja dhe kufoma e tij nuk është gjetur.

Jabllanicë

140. [REDAKTUAR] u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, dhe u mbajt i ndaluar në kazermën e UÇK-së në Jabllanicë. Gjatë kohës që ishte i ndaluar ai u rrah egërsisht nga anëtarë të UÇK dhe, si pasojë, vdiq [REDAKTUAR] rreth mesit të korrikut 1998.

141. [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në kazermën e UÇK-së në Jabllanicë që prej afërsisht [REDAKTUAR] 1998. Gjatë kohës që ishte i ndaluar ai u rrah egërsisht nga disa anëtarë të UÇK dhe për herë të fundit u pa kur mbahej nga UÇK-ja. Kufoma e tij nuk është gjetur.

142. [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në kazermën e UÇK-së në Jabllanicë që prej afërsisht [REDAKTUAR] 1998. Gjatë kohës që ishte i ndaluar, ai u rrah egërsisht dhe për herë të fundit u pa kur mbahej nga UÇK-ja, në gjendje të molisur, në fund të korrikut 1998. Anëtarë të familjes vazhdimisht pyetën për vendndodhjen e [REDAKTUAR], por u jepeshin informata kontradiktore dhe çorientuese. Kufoma e [REDAKTUAR] u gjet me plagë të shumta armësh zjarri [REDAKTUAR].

Llapushnik

143. [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në Llapushnik në fillim të qershorit 1998. Ai u rrah në mënyrë të përsëritur dhe u mor në pyetje çdo mbrëmje, me akuzën se ishte

bashkëpunëtor. Pas afërsisht dhjetë ditësh, më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u nxor jashtë dhe u vra [REDAKTUAR]. Kufomën e tij e morën disa anëtarë të UÇK-së dhe më vonë ai u gjet afër [REDAKTUAR].

144. Më 26 korrik 1998, ose rreth kësaj date, kur forcat serbe filluan një ofensivë, disa anëtarë të UÇK-së i morën afërsisht 30 të ndaluar dhe i çuan nga Llapushniku në Malet e Berishës aty afër, ku i ndanë ata në dy grupe. Njërin grup e zgjidhën dhe e liruan, ndërsa të ndaluarit në grupin tjetër i vranë me armë zjarri. Kufomat e të ndaluarve [REDAKTUAR] më vonë u zhvarrosën dhe u morën nga [REDAKTUAR].

Drenoc

145. [REDAKTUAR] u arrestua më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, dhe u soll në një ish-ndërtesë shkolle që përdorej nga UÇK-ja në Drenoc. Ai u rrah dhe u vra nga disa anëtarë të UÇK-së kur ishte i ndaluar. Kufoma e tij nuk është gjetur.

146. [REDAKTUAR] u arrestua në [REDAKTUAR] 1998 dhe u soll në Drenoc. Ai u rrah dhe, pas rreth 45 ditësh në ndalim, u vra nga disa anëtarë të UÇK-së. Kufoma e tij nuk është gjetur.

147. [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar në Drenoc që prej [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date. Ai u akuzua se ishte bashkëpunëtor dhe u rrah egërsisht. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, në Drenoc u ndalua edhe [REDAKTUAR]. Afërsisht më [REDAKTUAR] 1998, [REDAKTUAR] nga Drenoci [REDAKTUAR]. Që prej atëherë, të dy burrat nuk janë parë dhe prej tyre nuk është dëgjuar kurrë më. [REDAKTUAR]

148. Në [REDAKTUAR] 1998, [REDAKTUAR] u soll në Drenoc pasi ishte arrestuar në [REDAKTUAR] nga disa anëtarë të UÇK-së. Ai u akuzua se ishte spiun dhe për herë të fundit u pa kur mbahej nga UÇK-ja në Drenoc. Një pjesë e kufomës së tij u identifikua [REDAKTUAR].

149. [REDAKTUAR] u arrestua në shtëpinë e tij nga disa anëtarë të armatosur të UÇK-së më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, dhe u mbajt i ndaluar në Drenoc. Ai u rrah egërsisht dhe u vra nga disa anëtarë të UÇK-së. Kufoma e [REDAKTUAR] nuk është gjetur dhe familjes së tij nuk iu dha informacion për fatin e tij.

150. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së [REDAKTUAR] dhe u soll në Drenoc. Ai u rrah egërsisht dhe për herë të fundit u pa i gjallë kur mbahej nga UÇK-ja në Drenoc, [REDAKTUAR] 1998. Me gjithë kërkesat e përsëritura, familja e tij nuk u informua për fatin e tij. Një pjesë e kufomës së [REDAKTUAR] u identifikua [REDAKTUAR].

Malishevë

151. Më 17 korrik 1998, ose rreth kësaj date, një grup prej 11 të ndaluarish serbë u transferuan në një dhomë në bodrumin e një ndërtese në Malishevë, ku mbaheshin edhe dy të ndaluar të tjerë serbë. Anëtarë të UÇK-së që hynin në dhomë i rrahën dhe shkelmuan të ndaluarit. Rreth 19 korrikut 1998, [REDAKTUAR] të ndaluarit u nxorën jashtë me grupe. Të ndaluarit i hipën në një kombi dhe i çuan në një vend aty afër ku disa anëtarë të UÇK-së i vranë me armë zjarri. [REDAKTUAR]. Kufomat e [REDAKTUAR] burrave të tjerë u nxorën [REDAKTUAR]. Identitetet e viktimave jepen në Listën B.

152. Më 20 korrik 1998, ose rreth kësaj date, një grup të ndaluarish serbë u transferuan nga qendra e ndalimit në Drenoc në Malishevë. Në grup bënin pjesë persona që i ishin dorëzuar UÇK-së në Opterushë dhe Reti. Në grupin e transferuar ishin gjithashtu [REDAKTUAR]. Më 26 ose 27 korrik 1998, ose rreth këtyre datave, qendra e ndalimit në Malishevë u zbraz dhe, pas kësaj, anëtarë të UÇK-së i vranë disa të ndaluar, ndër të tjera edhe në një vend afër Volljakës. Me gjithë publicitetin e madh dhe kërkesat e vazhdueshme të anëtarëve të familjes, atyre nuk iu dha informacion

për fatin e personave që ishin mbajtur të ndaluar në Malishevë. Identitetet e viktimave të ditura jepen në Listën B.

Bajgorë

153. [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar nga anëtarë të UÇK-së në Bajgorë, Podujevë. Më [REDAKTUAR] 1998, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së e çuan [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], ku [REDAKTUAR] e morën në pyetje. Atij iu tha se në qoftë se nuk pranonte, do ta vrisnin. [REDAKTUAR]. Për herë të fundit ai u pa kur mbahej nga UÇK-ja. Kufoma e [REDAKTUAR], me shenja traumash të shkaktuara nga goditje me mjete të forta, [REDAKTUAR].

Majac

154. [REDAKTUAR] u mbajtën të ndaluar për periudha kohe të ndryshme dhe u keqtrajtuuan nga disa anëtarë të UÇK-së në Llapashticë, ndërsa më pas u mbajtën të ndaluar nga UÇK-ja në Majac që prej 25 marsit 1999, ose rreth kësaj date. Pretendohet se ata [REDAKTUAR]. Në Majac, të ndaluarit u urdhëruan [REDAKTUAR]. Kufomat e [REDAKTUAR] u zbuluan [REDAKTUAR].

Potok

155. [REDAKTUAR] u mbajtën të ndaluar për periudha kohe të ndryshme dhe u keqtrajtuuan nga disa anëtarë të UÇK-së në Llapashticë, ndërsa më pas u mbajtën të ndaluar nga UÇK-ja në Potok që prej 25 marsit 1999, ose rreth kësaj date. Pretendohet se [REDAKTUAR]. Kufomat e [REDAKTUAR] u zbuluan së bashku në [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

156. Rreth fundit të marsit 1999, një rom që kishte mbërritur nga një territor nën kontrollin e serbëve, u ndalua nga disa anëtarë të UÇK-së dhe u mbajt i lidhur në mes të fshatit [REDAKTUAR], Podujevë, ku e rrahën. Afërsisht pas dy ditësh, atë e çuan

në një postblllok në të dalë të fshatit, ku e vranë me armë zjarri me urdhër të Latif GASHIT.

Zllash

157. Afërsisht prej fillimit të prillit 1999, [REDAKTUAR] u mbajt i ndaluar dhe u keqtrajtua egërsisht në një bazë të UÇK-së në Zllash, Prishtinë. Familjes [REDAKTUAR] nuk iu dha informacion ose iu dha informacion i rremë për vendndodhjen e tij. [REDAKTUAR] u pa i gjallë për herë të fundit [REDAKTUAR] më 19 prill 1999, ose rreth kësaj date. [REDAKTUAR]. Kufoma e [REDAKTUAR] u gjet [REDAKTUAR].

Kleçkë

158. [REDAKTUAR] u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së së bashku me [REDAKTUAR] më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, afër [REDAKTUAR]. Ata u sollën në qendrën e ndalimit në Kleçkë ku anëtarë të UÇK-së i rrahën. [REDAKTUAR] vdiq si pasojë e lëndimeve të shkaktuara gjatë rrahjeve. Më [REDAKTUAR].

159. [REDAKTUAR] u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së më 9 mars 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] u zhduk më 15 mars 1999, ose rreth kësaj date, në [REDAKTUAR] dhe u mbajt nga anëtarë të UÇK-së. Të dy u transferuan në qendrën e ndalimit në Kleçkë ku u rrahën dhe keqtrajtuan. [REDAKTUAR] u morën nga qendra e ndalimit dhe u vranë nga disa anëtarë të UÇK-së më 5 prill 1999, ose rreth kësaj date. Kufomat e tyre nuk janë gjetur.

160. [REDAKTUAR] u arrestua nga disa anëtarë të UÇK-së në [REDAKTUAR] më 10 shkurt 1999, ose rreth kësaj date. Ai u ndalua nga UÇK-ja në Likoc dhe u transferua në qendrën e ndalimit në Kleçkë më 21 mars 1999, ose rreth kësaj date. Atë e liruan më 2 prill 1999, ose rreth kësaj date; një ditë pas lirimit u arrestua përsëri nga disa anëtarë të UÇK-së në Kleçkë dhe u vra me armë zjarri. Kufoma e tij nuk është gjetur.

161. [REDAKTUAR] u zhdukën më 9 shkurt 1999, ose rreth kësaj date. Ata u sollën në qendrën e ndalimit në Kleçkë dhe u mbajtën në atë vend ose rreth tij. Më 5 prill 1999, ose rreth kësaj date, ata u morën nga disa anëtarë të UÇK-së dhe u vranë aty afër me armë zjarri, me urdhër të Fatmir LIMAJT. Kufomat e tyre u gjetën më vonë në afërsi të atij vendi.

162. [REDAKTUAR] u ndaluan nga disa anëtarë të UÇK-së më 11 prill 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR]. Ata u sollën në qendrën e ndalimit në Kleçkë dhe u mbajtën në atë vend ose rreth tij. Më 18 prill 1999, ose rreth kësaj date, ata u morën nga disa anëtarë të UÇK-së dhe u vranë aty afër me armë zjarri ose me armë me teh të mprehtë. Më vonë, kufomat e tyre u nxorën [REDAKTUAR].

[REDAKTUAR]

163. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u rrah dhe u mbajt i ndaluar [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, këta katër burra ishin ndër ata [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, ata i transferuan në [REDAKTUAR], ku edhe i rrahën të gjithë. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, të katër burrat i nxorën një nga një nga dhoma ku mbaheshin të ndaluar prej anëtarëve të UÇK-së në [REDAKTUAR]. Që atëherë, asnjë prej tyre nuk është parë më. Anëtarëve të familjes nuk iu dha informacion për fatin e tyre.

Kukës, Shqipëri

164. Më 17 maj 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u arrestua dhe u mbajt i ndaluar nga disa anëtarë të UÇK-së në një ish-fabrikë metali në Kukës, Shqipëri. [REDAKTUAR] dhe të ndaluar të tjerë u rrahën egërsisht pothuaj çdo ditë nga disa anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët Sabit GEÇI. Më 4 qershor 1999, ose rreth kësaj date, gjatë një keqtrajtimi të tillë, [REDAKTUAR] u qëllua [REDAKTUAR]. Të nesërmen [REDAKTUAR] vdiq si pasojë e keqtrajtimit.

Ish-ndërtesa e MPB-së, Prizren

165. Më 17 korrik 1999, disa anëtarë të UÇK-së arrestuan [REDAKTUAR] në shtëpinë e tij në [REDAKTUAR], Prizren, dhe e mbajtën të ndaluar në ish-ndërtesën e MPB-së në Prizren. Atë e rrahën dhe, si pasojë, vdiq gjatë kohës që ishte i ndaluar, disa orë pas arrestimit. Më 18 qershor 1999, kufoma e [REDAKTUAR] u gjet [REDAKTUAR].

Rahovec

166. Më [REDAKTUAR], ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së morën [REDAKTUAR] nga shtëpitë e tyre në Rahovec. Ata i keqtrajtuan përpara se t'i merrnin. Më të njëjtën ditë, disa anëtarë të UÇK-së rrëmbyen të paktën edhe tre persona të tjerë. Kufoma e [REDAKTUAR] u gjet më vonë. Kufoma e [REDAKTUAR] nuk është gjetur.

167. Afër fundit të qershorit 1999, disa anëtarë të UÇK-së e morën [REDAKTUAR] me një veturë, nga [REDAKTUAR] në Rahovec. Për herë të fundit ai u pa kur mbahej nga disa anëtarë të UÇK-së dhe kufoma e tij nuk është gjetur.

168. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, [REDAKTUAR] u mor nga shtëpia e tij në Rahovec nga disa anëtarë të UÇK-së. [REDAKTUAR] ngacmimet dhe keqtrajtimi i anëtarëve të familjes së [REDAKTUAR] vazhduan. [REDAKTUAR] u pa për herë të fundit kur mbahej nga disa anëtarë të UÇK-së dhe kufoma e tij nuk është gjetur.

[REDAKTUAR]

169. Më [REDAKTUAR] 1999, ose rreth kësaj date, disa anëtarë të UÇK-së e morën [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] dhe e çuan në fshatin [REDAKTUAR], ku e morën në pyetje dhe e rrahën, [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR]. Që prej atëherë ai nuk është parë më.

[REDAKTUAR]

170. Në një datë midis korrikut dhe gushtit 1999, një civil i moshuar me kombësi serbe u keqtrajtua dhe u mbajt i ndaluar nga disa anëtarë të UÇK-së në një bazë të UÇK-së në [REDAKTUAR], Prishtinë. Dy ose tri ditë më vonë ai u vra nga disa anëtarë të UÇK-së dhe u varros në një varr jashtë bazës së UÇK-së.

Zhdukje me forcë e personave

171. Gjatë periudhës së aktakuzës, anëtarë dhe instrumente të NKP-së arrestuan, rrëmbyen ose ndaluan persona, me autorizimin, mbështetjen, ose pajtimin e heshtur të UÇK-së/QPK-së, në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore, duke përfshirë edhe në zona nën kontrollin e UÇK-së/QPK-së dhe në qendrat e ndalimit ose në lidhje me to, duke përfshirë edhe ato të identifikuara në Listën A. Kur anëtarë të familjes dhe persona të tjerë kërkonin informata për individët e zhdukur, anëtarët dhe instrumentet e NKP-së shpesh refuzonin t'u përgjigjeshin ose u jepnin informata të rreme apo çorientuese. Gjithashtu, ata shpesh i refuzonin kërkesat për qasje në qendrat e ndalimit ose për të vizituar të ndaluarit, i kërcënonin ose keqtrajtonin ata që kërkonin informata dhe nuk pyesnin dhe nuk bënin hetime për fatin ose vendndodhjen e personave të zhdukur. Ndër incidentet e zhdukjes me forcë të personave përfshihen ato të identifikuara në Listën C dhe të përshkruara në paragrafët 137, 139, 142, 147, 149, 150, 152, 157 dhe 163 më lart.

PARAQITJA E KRIMEVE

172. Përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI**, me anë të pjesëmarrjes së tyre në ndërmarrje kriminale të përbashkët kryen, dhe/ose ndihmuan dhe inkurajuan, krimet e paraqitura në këtë aktakuzë. Gjithashtu, ose si alternativë, **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** janë përgjegjës si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e tyre. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI**

dhe **Jakup KRASNIQI** dinin ose kishin arsye të dinin se krimet e paraqitura në këtë aktakuzë ishin në prag të kryerjes ose ishin kryer prej vartësve të tyre dhe nuk morën masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e atyre krimeve dhe për ndëshkimin e kryesve të tyre.

173. **Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Rexhep SELIMI dhe Jakup KRASNIQI** kanë personalisht përgjegjësi penale për:

Pika 1: PËRNDJEKJE për arsye politike dhe/ose etnike, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(h), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 2: BURGOSJE, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(e), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 3: ARRESTIM DHE NDALIM TË PALIGJSHËM OSE ARBITRAR, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 4: AKTE TË TJERA ÇNJERËZORE, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(j), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 5: TRAJTIM MIZOR, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 6: TORTURË, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(f), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 7: TORTURË, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 8: VRASJE E PALIGJSHME, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(a), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit;

Pika 9: VRASJE E PALIGJSHME, KRIM LUFTE, i ndëshkueshëm në bazë të neneve 14(1)(c)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit; dhe

Pika 10: ZHDUKJE ME FORCË E PERSONAVE, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, i
ndëshkueshëm në bazë të neneve 13(1)(i), 16(1)(a) dhe 16(1)(c) të Ligjit.

Të gjitha pjesët e kësaj aktakuze, duke përfshirë edhe Listat e saj, duhen lexuar bashkërisht me njëra-tjetrën.

_____/nënshkrim/_____

Xhek Smith

Prokuror i Specializuar

E mërkurë, 4 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.

LISTA A

QENDRAT E NDALIMIT

	KOMUNA	VENDNDODHJA	DATA E PËRAFËRT	NUMRI I PËRAFËRT MINIMAL I VIKTIMAVE TË IDENTIFIKUARA
KOSOVË				
1.	Drenas (Glllogoc)	1.1 Llapushnik	fundi i prillit deri 25 ose 26 korrik 1998	30
		1.2 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1998	13
		1.3 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
		1.4 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
		1.5 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
2.	Ferizaj	2.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
		2.2 Shtëpi në Ferizaj ose përreth	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
		2.3 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	5

	KOMUNA	VENDNDODHJA	DATA E PËRAFËRT	NUMRI I PËRAFËRT MINIMAL I VIKTIMAVE TË IDENTIFIKUARA
3.	Gjakovë	3.1 Jabllanicë	prill 1998 deri në fund të korrikut 1998	13
4.	Gjilan	4.1 Ish-shkolla me konvikt/konvikti në Gjilan	fundi i qershorit 1999	3
5.	Kaçanik	5.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	13
		5.2 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	4
		5.3 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	5
6.	Lipjan	6.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1998	4
		6.2 Shtëpi dhe ndërtesat përreth saj afër Kleçkës	nëntor 1998 deri qershor 1999	20
7.	Malishevë	7.1 Ish-stacioni i policisë në Malishevë	16 deri 26 ose 27 korrik 1998	48
		7.2 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	3

	KOMUNA	VENDNDODHJA	DATA E PËRAFËRT	NUMRI I PËRAFËRT MINIMAL I VIKTIMAVE TË IDENTIFIKUARA
8.	Novobërdë	8.1 Novobërdë	fundi i qershorit 1999	4
9.	Podujevë	9.1 Bare	gusht 1998	8
		9.2 Bajgorë	gusht 1998 deri në mes të shtatorit 1998	16
		9.3 Llapashticë	nëntor 1998 deri mars 1999	52
		9.4 Majac	25 mars 1999 deri 7 prill 1999	[REDAKTUAR]
		9.5 Potok	25 mars 1999 deri 7 prill 1999	[REDAKTUAR]
		9.6 [REDAKTUAR]	fundi i marsit 1999	1
10.	Prishtinë	10.1 [REDAKTUAR], Prishtinë	[REDAKTUAR] 1999	3
		10.2 [REDAKTUAR], Prishtinë	korrik ose gusht 1999	1
		10.3 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA	DATA E PËRAFËRT	NUMRI I PËRAFËRT MINIMAL I VIKTIMAVE TË IDENTIFIKUARA
		10.4 Zllash	shtator 1998	[REDAKTUAR]
			1 deri 19 prill 1999	7
11.	Prizren	11.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1998	5
		11.2 Ish-ndërtesa e MPB-së në Prizren	16 deri 18 qershor 1999	15
		11.3 [REDAKTUAR] Prizren	15 deri 23 qershor 1999	8
		11.4 [REDAKTUAR] Prizren	16 deri 19 qershor 1999	2
		11.5 [REDAKTUAR] Prizren	26 qershor 1999	3
12.	Rahovec	12.1 Drenoc	maj 1998 deri korrik 1998	38
		12.2 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	[REDAKTUAR]
13.	Skënderaj	13.1 Ish-stacioni i policisë dhe vende të tjera në Likoc	prill 1998 deri janar 1999	25

	KOMUNA	VENDNDODHJA	DATA E PËRAFËRT	NUMRI I PËRAFËRT MINIMAL I VIKTIMAVE TË IDENTIFIKUARA
		13.2 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1998	13
14.	Suharekë	14.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	7
		14.2 Ish-stacioni i policisë në Suharekë	fundi i qershorit 1999	1
15.	Viti	15.1 [REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	9
SHQIPËRI				
16.	Rrethi i Kukësit	16.1 Fabrika e metalit në Kukës	maj deri qershor 1999	20
17.	Rrethi i Hasit	17.1 Cahan	prill deri qershor 1999	17

LISTA B

VRASJE E PALIGJSHME OSE VRASJE

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
KOSOVË				
1.	Drenas (Glllogoc)	Malet e Berishës afër Llapushnikut	25 ose 26 korrik 1998	1.1 [REDAKTUAR] 1.2 [REDAKTUAR] 1.3 [REDAKTUAR] 1.4 [REDAKTUAR] 1.5 [REDAKTUAR] 1.6 [REDAKTUAR] 1.7 [REDAKTUAR] 1.8 [REDAKTUAR] 1.9 [REDAKTUAR]
2.	Drenas (Glllogoc)	Llapushnik	[REDAKTUAR] 1998	2.1 [REDAKTUAR]
3.	Ferizaj	[REDAKTUAR]	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1999	3.1 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
4.	Ferizaj	[REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	4.1 [REDAKTUAR] 4.2 [REDAKTUAR] I 4.3 [REDAKTUAR] 4.4 [REDAKTUAR]
5.	Gjakovë	Jabllanicë	rreth ose pas mesit të qershorit 1998	5.1 [REDAKTUAR]
6.	Gjakovë	Jabllanicë	mesi i korrikut 1998	6.1 [REDAKTUAR]
7.	Gjakovë	Jabllanicë	[REDAKTUAR] 1998	7.1 [REDAKTUAR]
8.	Klinë	Shpella e Volljakës (dhe Malishevë, Malishevë)	26 ose 27 korrik 1998	8.1 [REDAKTUAR] 8.2 [REDAKTUAR] 8.3 [REDAKTUAR] 8.4 [REDAKTUAR] 8.5 [REDAKTUAR] 8.6 [REDAKTUAR] 8.7 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
				8.8 [REDAKTUAR] 8.9 [REDAKTUAR]
9.	Klinë	Shpella e Volljakës (dhe Malishevë, Malishevë)	26 ose 27 korrik 1998	9.1 [REDAKTUAR] 9.2 [REDAKTUAR] 9.3 [REDAKTUAR] 9.4 [REDAKTUAR] 9.5 [REDAKTUAR] 9.6 [REDAKTUAR] 9.7 [REDAKTUAR] 9.8 [REDAKTUAR] 9.9 [REDAKTUAR] 9.10 [REDAKTUAR] 9.11 [REDAKTUAR] 9.12 [REDAKTUAR] 9.13 [REDAKTUAR] 9.14 [REDAKTUAR] 9.15 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
10.	Klinë	Shpella e Volljakës (dhe Malishevë, Malishevë)	26 ose 27 korrik 1998	10.1 [REDAKTUAR]
11.	Lipjan	Kleçkë	3 prill 1999	11.1 [REDAKTUAR]
12.	Lipjan	Kleçkë	[REDAKTUAR] 1999	12.1 [REDAKTUAR]
13.	Lipjan	Kleçkë	5 prill 1999	13.1 [REDAKTUAR]
14.	Lipjan	Kleçkë	5 prill 1999	14.1 [REDAKTUAR]
15.	Lipjan	Kleçkë	5 prill 1999	15.1 [REDAKTUAR] 15.2 [REDAKTUAR]
16.	Lipjan	Kleçkë	18 prill 1999	16.1 [REDAKTUAR] 16.2 [REDAKTUAR] 16.3 [REDAKTUAR] 16.4 [REDAKTUAR] 16.5 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
17.	Malishevë	Malishevë	më 18 ose 19 korrik 1998, ose rreth këtyre datave	17.1 [REDAKTUAR] 17.2 [REDAKTUAR] 17.3 [REDAKTUAR] 17.4 [REDAKTUAR] 17.5 [REDAKTUAR] 17.6 [REDAKTUAR] 17.7 [REDAKTUAR] 17.8 [REDAKTUAR] 17.9 [REDAKTUAR] 17.10 [REDAKTUAR] 17.11 [REDAKTUAR] 17.12 [REDAKTUAR] TIQ
18.	Malishevë	Malishevë	rreth ose pas 26 ose 27 korrikut 1998	18.1 [REDAKTUAR] 18.2 [REDAKTUAR]
19.	Podujevë	Bajgorë	rreth ose pas 30 gushtit 1998	19.1 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
20.	Podujevë	[REDAKTUAR]	fundit i marsit 1999	20.1 Një rom i paidentifikuar
21.	Podujevë	Majac	fillimi i prillit 1999	21.1 [REDAKTUAR] 21.2 [REDAKTUAR] 21.3 [REDAKTUAR]
22.	Podujevë	Potok	fillimi i prillit 1999	22.1 [REDAKTUAR] 22.2 [REDAKTUAR]
23.	Prishtinë	[REDAKTUAR], Prishtinë	korrik ose gusht 1999	23.1 Një serb i paidentifikuar
24.	Prishtinë	Zllash	midis afërsisht 19 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999	24.1 [REDAKTUAR]
25.	Prizren	Ish-ndërtesa e MPB në Prizren	17 ose 18 qershor 1999	25.1 [REDAKTUAR]
26.	Rahovec	[REDAKTUAR]	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1999	26.1 [REDAKTUAR]
27.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	27.1 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
28.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	28.1 [REDAKTUAR]
29.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	29.1 [REDAKTUAR] 29.2 [REDAKTUAR]
30.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	30.1 [REDAKTUAR]
31.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	31.1 [REDAKTUAR]
32.	Rahovec	Drenoc	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1998	32.1 [REDAKTUAR]
33.	Rahovec	Rahovec	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1999	33.1 [REDAKTUAR]
34.	Rahovec	Rahovec	rreth ose pas [REDAKTUAR] 1999	34.1 [REDAKTUAR]
35.	Rahovec	Rahovec	[REDAKTUAR] qershorit 1999	35.1 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
36.	Skënderaj	Likoc	midis [REDAKTUAR] 1998	36.1 [REDAKTUAR] 36.2 [REDAKTUAR] 36.3 [REDAKTUAR] 36.4 [REDAKTUAR] 36.5 [REDAKTUAR] 36.6 [REDAKTUAR]
37.	Skënderaj	Likoc	[REDAKTUAR] 1998	37.1 [REDAKTUAR]
38.	Skënderaj	Likoc	rreth ose pas janarit 1999	38.1 [REDAKTUAR]
SHQIPËRI				
39.	Rrethi i Kukësit	Ish-fabrika e metalit në Kukës	5 qershor 1999	39.1 [REDAKTUAR]

LISTA C

ZHDUKJE ME FORCË E PERSONAVE

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT E ZHDUKJES	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
1.	Ferizaj	[REDAKTUAR]	[REDAKTUAR] 1999	1.1 [REDAKTUAR] 1.2 [REDAKTUAR] 1.3 [REDAKTUAR] 1.4 [REDAKTUAR]
2.	Prishtinë	Zllash	19 prill 1999	2.1 [REDAKTUAR]
3.	Gjakovë	Jabllanicë	[REDAKTUAR] 1998	3.1 [REDAKTUAR]
4.	Malishevë	Malishevë	rreth ose pas 26 ose 27 korrikut 1998	4.1 [REDAKTUAR]
5.	Rahovec	Drenoc	[REDAKTUAR] 1998	5.1 [REDAKTUAR] 5.2 [REDAKTUAR]
6.	Rahovec	Drenoc	[REDAKTUAR] 1998	6.1 [REDAKTUAR]

	KOMUNA	VENDNDODHJA PËRKATËSE	DATA E PËRAFËRT E ZHUKJES	VIKTIMA TË IDENTIFIKUARA
7.	Rahovec	Drenoc	[REDAKTUAR] 1998	7.1 [REDAKTUAR]
8.	Skënderaj	Likoc	[REDAKTUAR] 1998	8.1 [REDAKTUAR] 8.2 [REDAKTUAR] 8.3 [REDAKTUAR] 8.4 [REDAKTUAR] 8.5 [REDAKTUAR] 8.6 [REDAKTUAR]
9.	Skënderaj	Likoc	janar 1999	9.1 [REDAKTUAR]